


BIBLIOTEKA E

854-93-32

SHETETI

G 91.

GJIROKASTER



# GUXIMTARET E VEGJEL

BIBLIOTEKA E

854-93-32

854-93-32

SHTETI

E K A E P I O N I E R I T

G 91

GJIROKASTER

# GUXIMTARËT E VEGJËL

(TREGIME)

925 ~~45580~~

BIBLIOTEKA E SH.  
GJIROKASTER

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

## BRIGADA I QEPET MALIT

### I.

Dëbora e dhjetorit bie pa kursim. Bjeshtë mbi fshat i ka mbuluar coha e bardhë dhe e trashë.

Fshati i bjeshkëve Terpullas, si për t'u mbrojtur nga suferina, është strehuar në një gropë të thellë gjigante të malit. Shtëpitë e tij të shpërndara duken si ishuj të vegjël në detin e pjerrët të dëborës.

Sa vend i bukur është ky fshat!

Maja e gjerë e bjeshkës mbi të, me ato krepas, duket si bedenat e një kështjelle kreshnike natyrore. Në këtë kështjellë janë strehuar në shekuj trimat shqiptarë. Që këtej ata sulleshin me pushkë e flamur në duar dhe u sillnin vdekjen pushtuesve armiq.

Po tokë për bukë, a ka këtu?

Në Terpullas ka gjashtëdhjetë e ca shtëpi me njëzet hektarë tokë.

Vështrojani faqen e malit! Arat e vockla, si arna në rrobën e bjeshkës janë hapur me thonj në taraca. E këto taraca mbahen me mure të larta gjer në pesë metra.

Dëbora, kjo brucë e rëndë dhe e akullt i mbulon këto toka pesë gjashtë muaj në vit.

Dikur në dimër fshatarët strukeshin pranë vatrës. Dhe buka e pakët nuk mjaftonte as për katër muaj.

Po tani qetësia dimërore e bjeshkëve të Terpullasit u prish. Fjala e kongresit të partisë buçet si jehonë nga bjeshka në bjeshkë...

## II.

Ceni ishte ngjitur në majë të një shkëmbi mbi fshat. Nga kjo majë brinja e malit dhe fushat poshtë dukeshin sikur i mbaje në pëllëmbë të dorës.

Monopatit të fshatit po ngjitej një varg i gjatë njerëzish. Në krye të kolonës dallohej flamuri i kuq.

— Ej, ej! — u thirri Ceni shokëve që silleshin rreth bagëtive brinjës së malit. — Po vinë partizanët! Po vinë partizanët!

Carrokët e fshatit u mblodhën te shkëmbi. Të gjithë të habitur dëshironin të shkonin kush ishin këta partizanë.

Selmani qeshi.

— Këta s'janë partizan mor Cen! Janë vullnetarët e fushës. Ata vinë për t'ju qepur maleve, si ka thënë Xhaxhi Enver. Të gjëmojnë përsëri malet e shkrepat, si atëhere kur ngritën fole partizanët!

— Të zbresim shpejt në fshat dhe të japim lajmin të parët! — propozoi Ceni.

Disa mbetën me bagëtinë. Të tjerët, si kecërit këmbëshpejtë, u turrën tatëpjetë shkrepave.

### III.

Njëshkolona e brigadës me flamur të kuq në krye po i afrohej sheshit të fshatit. Kënga e vullnetarëve buçiste:

«Lum e lum ku erdhëm ne  
Sot në punë vullnetare,  
thirrjes që bëri partia,  
ju përgjegj e gjithë rinia!  
Urdhëri që dha Enveri,

— Mirë, mirë, o Cen! Ti ke të drejtë. Të gjithë duhet të punojmë, ndryshe nuk nxjerrim dot bukë nga guri e shkrepë. Por, shiko! Pa të provuar si punon, nuk të pranojmë në kompani.

Ceni i gëzuar u drejtua atje ku punonte kompania e katërt.

## VI.

Në muzgun e asaj dite ndodhi një fatkeqësi. Një shkëmb i vogël u rrokullis tatëpjetë dhe plagosi rëndë në këmbë një vullnetar të kompanisë së katërt. Të gjithë u mblodhën në vendin e ngjarjes, po asnjëri nuk i vinte dot në ndihmë të plagosurit.

Dikush kujtoi infermierin e fshatit, i cili kish vajtur për të mjekuar një plak të sëmurë, por ai ndodhej shumë larg. Kushdo nga të rriturit që të shkonte për ta thirrur, nuk do të kthehej dot pa kaluar dy orë.

Po errej.

Ceni thërriti: «Vete unë!» dhe u sul me vrap. Por komandanti i kompanisë e ndali për një çast. Ai hodhi vështrimin dhe vuri re pëlhurën pis të zezë të natës, që po ulej mbi bjeshkë.

— A ke frikë të nisesh vetëm, natën, Cen? — e pyeti komandanti.

— Unë jam si korierët e partizanëve!

— Po mund të të dalin ujqërit përpara!

— Mos kini frikë! Më jepni një kuti shkrepëse, do të marr me vete edhe një copë pishë... dhe s'ua vë veshin ujqërve.

Dhe Ceni u zhduk.

Nuk kaloi asnjë orë dhe të plagosurit ju bënë të gjitha mjekimet në vend.

## VII.

Mëngjez i ditës së nesërme.

Kompania e katërt e vullnetarëve u rrjeshtua për tu nisur në punë. Komandanti bëri apelin si zakonisht. Një shok i plagosur mungonte. Por në fund të listës komandanti shqiptoi si vullnetar të ri të kompanisë Cenin, malësorin e vogël. Gjithë kompania duartrokiti. Ky ishte një ushtar i ri i detashmentit kundër shkëmbinjve të gurtë, për tarracat pjellore të maleve.

Atë çast Ceni nuk u përgjegj «këtu.» Ai tani ndodhej në klasë, në mësim. Po pasdite, kur të vinte me bel në krah për të punuar, me siguri do të gëzohej shumë që atë e kishin pranuar në kompaninë e katërt.

fshati po ndahet ma mirë me të korrurat se sa vjet që s'ishte kooperativë?

Gjithë këtë ngjarje ja treguam të nesërmen mësuesit. Ai na tha se kisha kishte qenë gjithmonë pengesë e zhvillimit të jetës në fshat dhe e sukseseve tona. Për këtë ajo kishte përdorur dhe vazhdonte të përdorte shumë forma propagande për të tërhequr fshatin nga rruga e kolektivizimit.

— Sa për mrekullitë e statujës, — tha mësuesi, — prisni pak ditë dhe do të shihni sa qesharak ka për t'u bërë prifti kur t'i zbulohet «sekreti». Edhe ju vetë mund të veproini të zbulohet ky «sekret».

Ne të gjithë filluam të mendojmë për «sekretin e lotëve». Deri sa tha mësuesi se kish një «sekret», nuk duhej dyshuar aspak për këtë.

Caktuam Nolin, kujdestarin e klasës IV, si drejtues të grupit dhe u vumë në kërkim. Kot që pyetëm dhe menduam në dy-tri ditët e para, s'po gjenim gjë. Shumë veta na thoshin se «mrekullitë e zotit» janë të paspiegueshme. Na vinte keq sidomos, kur na thoshin plakat: «Mos Shën-Mëria asht zemërue, sepse u krijue kooperativa?»

Nuk mbeti tjetër veç të hynim në kishë



fshehurazi dhe ta shihnim nga afër statujën e Zojës.

— Duhet hyrë vonë në të ngrysur që të mos diktohem, — tha Noli.

U caktuam tri veta: Noli, unë dhe Gimi, djali i mësuesit.

Në mbrëmje, pasi u errësua, shkuaam të tre tek mulliri pa u dalluar fare prej askujt e ju afruam kishës. I pari kërceu Gimi mbi kurrizin tim, çeli dritaren dhe u fut brenda. Pas tij hyri Noli dhe i fundit unë. Shkrepsja që patëm me vete, na bëri punë.

Që të tre hypëm me radhë mbi altar dhe pamë «sekretin». Na erdhi për të qeshur si nuk ishim kujtuar më përpara për një mrekulli të tillë. Të nesërmen «sekretin e lotëve» e mësuan gjithë shokët. Po atë mëngjez morëm tri vendime: Të mos flisnim deri të dielën e meshës, të ngjitnim një fletërrufe në portën e Shën-Gjonit në mëngjezin e meshës, secili të mbushte në shtëpinë e vet enët e ujit që të shtunën në darkë.

Zotimet i mbajtëm. Të dielën u zgjuam herët.

— Ku shkoni? — na pyesnin njerëzit që po drejtoheshin për në kishë.

— Atje ku shkoni edhe ju, — u përgjigjeshim ne.



Pasi filluan të hyjnë në kishë, Vata i vogël, pa u diktuar, e ngjiti fletërrufenë në derën e «shtëpisë së shenjtë». Ata që e lexuan, i përhapën vesh më vesh fjalët e parullës sonë: «Për arësye riparimi të tubit kryesor të ujësjellësit, sot Shën-Mëria nuk vajton».

Ne fëmijëve që ishim brenda në kishë, nuk na rrihej; prisnim me ankth në se do të na dilte me sukses puna, që kishim marrë përsipër.

Çdo gjë varej nga Cini dhe Shpendi, që ishin caktuar të ngjiteshin tek depua e ujësjellësit të fshatit dhe të bisedonin me xha Kolën për t'ja ndërprerë ujin fshatit nja dy orë. Si do ta kryenin vallë detyrën ata të dy? A do ta bindnin dot xha Kolën?

Çdo gjë vajti në rregull. Mesha filloi e mbaroi e Shën-Mëria nuk derdhi lot si herën tjetër. Prifti u përpoq të gjente shpëtim dhe tha:

— O njerëz besimtarë! Shikoni si po qesh sot Shën-Mëria!

Shën-Mëria në të vërtetë as nuk po qeshte as nuk po qante.

Dikush foli nga fundi:

— Sot po qesh, o Dom Koleci, sepse s'po mundet me qa!

Një tjetër ja priti:

— Duket se po i ruan lotët për javën tjetër kur të rregullohet ujësjellësi.

Plasi një zhurmë dhe poterë në kishë, sa që u ndërpre mesha. Njerëzit filluan të dalin. Prifti po ngutej për të mbyllur kishën.

Shumica qeshnin, kurse disa pleq pësh-tynin duke mallkuar të pafetë që e prishën meshën. Dhe këta ishin sigurisht gjyshërit që mbaheshin me bastun.

Prifti i mori masat po atë ditë. I hoqi tubat e ujit që kishte instaluar në trupin e statujës, sigurisht për të mos ju zbuluar dhe më petët lakrorit.

Megjithatë, s'mbeti njeri pa e marrë vesh si qe puna e lotëve të Shën-Mërisë.

## DRITA E DIELLIT

Bardhësia e borës rrihej nga rrezet e diellit dhe të merrte sytë. Tej ajo humbiste në një velo të hollë me ngjyrë të kaltër, sa të dukej, se vetë qielli i pastër kish rënë duke mbuluar arat, bjeshkët, malet, pemët. Nga pishat e mëdha era lëkundëte degët e rënduara dhe që andej këputeshin masa të ngrira bore, që në rënjen e tyre të rrufeshme, duke u goditur nga rrezet e diellit, formonin vezullime prej kristali të zjarrtë. Dhe nga gjiri i kësaj natyre dimri ushtoi kori i zërave: njerëzit, kafshët, zogjtë u vunë në gjallëri; agoi dita e re...

Vetëm te kulla e Prendajve ai mëngjez i mrekullueshëm po qëndronte ende i ngrysur, i ftohtë akull, kulla ende po vazhdonte jetën e mëparshme. Po të njëjtat blegërima delesh në haur, po ai çajnik në zjarr, po të njëjtat shtëllunga tymi ngriheshin nga llulla e babës,

po të njëjtat hapa të lehta të nënës në dhomën tjetër. Vetëm në qoshen kundruall, shtrati gjithë natën kish mbetur i ftohtë dhe bosh: Paloku, pasi ish-munduar t'i mbushte mendjen babait që të hynte në kooperativë dhe s'kish arritur asnjë përfundim, që larguar me grindje. Ndërsa sot do të largohej edhe Sokoli i vogël. Megjithëse mbrëmë kish rënë shumë vonë për të fjetur, ai kish kohë që që zgjuar. Donte të qëndronte edhe pak në atë dhomë ku kish lindur dhe po rritej, donte t'i shihte edhe pak muret, orenditë, zjarrin, nënën dhe babanë e tij. Rrinte shtrirë pa bërë zë. Shihte se si rrezet e diellit përpiqeshin të depërtonin gjer tej, por shtëllungat e mëdha të tymit të llullës i përthyenin. Ai ua kish ngulur shikimin atyre rrezeve që ndesheshin me shtëllungat e tymit sikur diçka priste nga ndeshja e tyre. Pas pak do të ngrihej dhe do të shkonte të banonte me Palokun. . . Mbrëmë që grindur keq me babanë. Çdo gjë i kujtohej me hollësi.

Pasi qenë larguar disa fshatarë që kishin biseduar me babanë për të hyrë në kooperativë dhe pasi ai vetë kishte kuptuar se babai ende s'po bindej, ja kish shkrepur të qarit.

— Pse po na ndan nga fshati, baba?! Më vjen turp të qëndroj midis shokëve. Ata gjithë

gëzim bisedojnë për punën e përbashkët të prindërve të tyre, për mrekullitë që u tregojnë vullnetarët e rinj, që kanë ardhur nga kooperativat e fushës në ndihmë të kooperativës së re. Vetëm unë rri i veçuar, larg gëzimit dhe lumturisë së përbashkët, nga të cilat ti po na ndan.

— Hesht more, je ende i vogël — ja ktheu i ati. — Do të na tregosh ti si të bëjmë! Apo të ka mësuar Paloku?

— Në më ka mësuar, s'ka bërë keq. Veç dhe aq i vogël sa thua ti, nuk jam.

— E shoh, e shoh, — ju përgjegj babai i ngrysur. — Po del mbi babanë, ja kthen fjalën sikur të jetë ndonjë shoku yt.

Sokoli heshti, e pa të jatin drejt në sy dhe i goditur keq nga që s'po e kuptonte drejt, duke përmbajtur dënesën që donte të çante kraharorin e tij të njomë, ja ktheu:

— Mos, babë, me ato fjalë! Unë e di që kam të drejtë, ashtu si ka edhe Paloku edhe katundi. Për të mirën tonë e them, për të ardhmen.

— Për të mirën tonë! — qeshi babai hi-dhur. — T'i heqim bagëtitë tona nga vatha, t'i lëshojmë arat tona në duart e të tjerëve! Kjo qenka e mira jonë, or çun?

— T'i bashkojmë me të gjithë katundin,

të punojmë me gjithë katundin. A s'na ke thënë vetë se trimi i mirë fiton me shokë shumë? Ç'do të bëjmë ne të vetmuar me tufën tonë ndarë nga tufa e madhe, me arat tona ndarë nga arat e përbashkëta?

Babai ja nguli sytë të birit dhe e vështroi gjatë. «Folka, apo s'folka çunaku — mendoi dhe ndjeu t'ja përshkonte kraharorin një ndjenjë e ngrohtë krenarie — po bëhet i zgjuar dreqi, ta pleqëron muhabetin sikur të jetë dyzet vjeç burrë». Po menjëherë kjo ndjenjë ju zbeh kur mendoi se edhe ky qe ngritur kundër tij, kundër mallit të shtëpisë. E pa vëngër:

— Hesht, mor djalë! Do të rritesh dhe do ta kuptosh sa keq po flet. Dëgjo babën ti!

— Po Paloku, babë? Po katundi? Vetëm ti e rreh drejt këtë punë, ndërsa gjithë katundi qenka gabuar?

Përsëri babai shtangu nga përgjigja e ndezur. Por tanimë i dërmuar nga përgjigjet e mençura të të birit ai u ndez nga zemërimi dhe nisi të fliste me zë të lartë pa ditur se kujt t'i shfërhej:

— Ne kemi punën tonë. Fshati le të bëjë punën e vet!

— Jo, ne s'do të ndahemi nga fshati!

— Atë e thua ti!



— E them dhe do ta bëj! — u përgjegj Sokoli me sytë shpuzë.

— Çfarë the?!

— Nesër do të largohem edhe unë. Do të banoj me Palokun. Pas dy vjetësh mbaroj shkollën 8 vjeçare dhe do të bëhem anëtar i kooperativës. Unë s'mund të jetoj veç nga shokët.

Babai ngriu nga këto fjalë, që nuk i priste prej të voglit, ndërsa nëna psherëtiu thellë dhe ju mbushën sytë me lot.

— Ç'bën, o burrë, — i tha — po na ndan nga fëmijët për së gjalli.

— Le të ndahen! — tha ai me kokën lëshuar mbi gjunjë dhe nuk foli më asnjë fjalë. Pastaj ai u mbulua nga shtëllungat e tymit. . .

Këto fluturimthi i kalojnë Sokolit në kujtesë dhe e dredhin. Ai është i bindur se kështu s'mund të jetohet më, po prapë ndjen në zemër një ndjenjë të hidhur. Ç'do të bënte babai paskëtaj? . . . Ngre pak kokën dhe e sheh... Ja ai, me sytë ngulur mbi çajnikun që gurgullon në zjarr, mendon i zhytur thellë në mendime. As flet, as lëviz — vetëm heq llullën, — tymos, tymos i menduar, i heshtur. Po këtë qëndrim kishte mbajtur edhe mbrëmë. Mos vallë gjithë natën kish qëndruar atje duke luftuar me mendimet e tij, ja ashtu si po luf-

tojnë rrezet e diellit me shtëllungat e duhanit?

I dashur babë. Ç'po ngjet me ty? Si vallë s'po e hedh ende atë hap, që do të të bashkojë me fëmijët, me fshatin, me njerëzit? A s'e sheh që ne s'mund të qëndrojmë më kështu?...

Zemra e djalit mbushet me mallëngjim e keqardhje dhe nuk duron dot më, por e hedh tej jorganin.

Babai ngre kryet lart:

— U zgjove, Sokol i babës?

Djali e përmban mallëngjimin dhe i vendosur thotë:

— Po babë, erdhi koha të iki!

— Mos u nxito, bir, unë jam si shkëmbi: dielli i mëngjezit nuk e ngroh shpejt, po kur e ngroh... Dhe djali e pa si u ngrit në këmbë tamam si i ri.

— O grua, — i thirri së shoqes, — ma sill atë pushkë!

Mori pushkën, i futi një krëhër fishekësh dhe hapi kanatën e dritares:

— Ta mësojë fshati se Kolë Prenda nuk ndahet prej tij. Kjo për Partinë që na tregon rrugën e drejtë, — tha dhe shtiu. — Kjo për djemtë, që ajo i mësoi të na çelin sytë dhe ne pleqve, — tha dhe shtiu përsëri. — Kjo për ty, o grua, — tha duke shtirë për herë të tre-

të. — Ndërsa për mua shtjerë ti, o Sokol, që të ka baba trim e burrë me mend. Thuaji fshatit se Kolë Prenda po hyn në kooperativë, — dhe ja lëshoi pushkën djalit në dorë.

Tri krismat mes oshëtimës së tyre lajmëtare e bënë Sokolin të fluturonte nga gëzimi. Shtërngoi pushkën fort dhe shtiu.

Pas pak u hap dera. Hyri Paloku, hynë fshatarët, hyri tok me ta dielli i madh, i zjarrtë. Atë s'kish më ç'e ndalte: shtëllungat e tymit qenë zhdukur dhe dhoma u bë dritë, dritë si drita e diellit.

## DO TË BEHEM GURSKALITËS SI GJYSHI

Edhe Fejziut, nxënësit tim të klasës VI, i shkëlqenin sytë nga gëzimi, por qëndrimi i tij tregonte atë çast se ai bluante edhe diçka tjetër në vetvete.

Gjyshi i tij, xha Tasi, kish qenë gurskalitës me emër në qytet dhe tani pensionist, drejtonte rrethin e gurskalitësve të shkollës. Ajo që na habiti të gjithëve, ish se në listën e gurskalitësve të klasës VI, emri i Fejziut mungonte. Në fillim menduam mos ish harruar, pasi pjesëmarrjen e tij as që e vinim në dyshim.

— Paskemi harruar emrin tënd, Fejzi, — i tha udhëheqësja.

— Unë nuk do të vij në rreth.

— Pse?!

— Tani prodhohen aq shumë tulla, sa nuk ka nevojë për gurë, — tha ai.

— Po gjyshi yt para pak kohe punonte si gurskalitës dhe punën e tij e çmonin të gjithë.

— Gjyshi edhe tani që është në pension bën, ç'bën, e i bie ndonjë guri me çekan, kurse unë s'kam ndërmend të bëhem gurskalitës.

Shokët nuk e kishin zgjatur më. Ata e dinin se Fejziu mendonte gabim dhe do të përpiqeshin, që jo me fjalë, por me vepra t'i mbushnin mendjen, se nuk kish të drejtë kur mendonte ashtu.

Kompanitë u ndanë në brigada. Çdo brigade, i binte të vinte një herë në javë për skalitje, veç ditës që merreshin me rregullimin e kalldrëmeve, në rrugicat pranë shkollës.

Atë ditë e kishte radhën klasa VI. Ustai, kështu i thërrisnin disa xha Tasit, nuk kishte ardhur ende. Megjithatë, secili mori gurin e tij dhe pasi vunë «syzet», filluan punën. Xha Tasi erdhi pak me vones atë mbasdite, por mbetëm të habitur kur njëri ngriti kokën dhe tha: «Shikoni kush po vjen». Kthyem kokat menjëherë dhe pamë, se në krah të ustait, po ecte Fejziu që, si i gjyshi, mbante dhe ai një çekiç në dorë.

— Sot ju mbush mendja të vijë, — tha njëri.

— Të shohim ç'do të na thotë, — ja priti një tjetër.

Xha Tasi si gjithnjë u uroi punë të mbarë të vegjëlve, por nuk filloi t'u shohë punën, si zakonisht. Qëndronte i menduar. Pionierët,

duke parë që ustai diç desh t'u thosh, e lanë punën dhe po prisnin.

— Siç e shihni, — filloi ai me buzë në gaz — sot na erdhi edhe Fejziu. U kujtua ca vonë, por unë do ta ndihmoj t'ju arrijë. Do të thotë edhe ai nja dy fjalë.

— Hë, Fejzi, — ju kthye të nipit, — mos u druaj t'u thuash të vërtetën shokëve të tu — i dha zemër gjyshi.

— Unë... unë, — filloi ai dhe u bë flakë, — nuk erdha që në fillim, se mendoja ndryshe. Ç'më duhet mua të skalis gurin, kur unë do të vete në universitet? Kështu mendoja deri dje. Por sot mendoj ndryshe. Unë e lexova edhe një herë letrën e shokut Enver dhe ajo më hapi sytë dhe më tregoi rrugën e vërtetë. Unë do të bëhem gurskalitës si gjyshi. Ju lutem më pranoni në radhët tuaja!

Pastaj u bë qetësi. Dikush andej nga fundi e prishi heshtjen, duke i rënë një guri me çekiç.

— Merre këtë gur, Fejzi, se është më i lehtë për t'u skalitur, — i tha dhe i ra me çekiç përsëri, gurit.

— Punë të mbarë! — e uroi një tjetër dhe filloi të rrahë me çekiç gurin e vet. Goditjet i pasuan të tjerët dhe pas pak veç goditjeve të çekanëve mbi gur, s'dëgjohej zhurmë tjetër.

## TUNELI

(Skicë)

Tuneli! E kush nuk e ka dëgjuar këtë fjalë?! Kush ka udhëtuar me tren, ka parë me sy: vrima të mëdha që çajnë mespërmes bar-kun e malit. Ehu! E ç'janë ato tunele ku kalon treni? Po të shikoni tunelin e madh, që po hapet në Vaun e Dejës! Keni dëgjuar për këtë vend? Këtu nisi jetën një hidrocentral i ri. Oho, çfarë hidrocentrali! Tani ai është i voc-kël, si një fëmijë që e ushqejnë me qumësht. Por hidrocentrali nuk është si gjithë fëmijët e tjerë. Atë nuk e qetësojnë dot vetëm duart e një nëne. Ndaj atje kanë shkuar qindra e qindra njerëz: nënat, baballarët, vëllezërit e mo-trat tona. Aa e ushqejnë këtë foshnje me djer-së, i rrijnë gjithmonë mbi kokë, natën i qën-drojnë me radhë pranë shtratit që, nesër, kur ai të rritet, të bëhet i shëndoshë, ta dojë ven-din e tij, t'ua shpërblejë me nder gjithë atyre

prindërve, që e përkundën me duart e tyre.

Tuneli! Në të do të vërshojnë ujrat e rrëmbyeshëm të Drinit plak. Keni për të parë se si do të turfullojë Drini nga inati, kur t'i thonë «Ndal! Mjaft ke ecur nga të donte qejfi! Mjaft ke përmbytur fusha e fshatra! Tani do të ecësh këtej, nga duam ne». Dhe në tunelin me gjatësi 255,5 m. me gjerësi e lartësi 13 m. babushi Drin do ta ndjejë veten ca ngushtë, ndoshta do t'i zihet dhe fryma, kur të kalojë nëpër atë vrimë të gjatë, që depërton tej e tej malin. Ndoshta edhe do të shfryjë nga inati e do të mundohet të dalë nga shtrati. Por ku do të vejë? Tuneli është i fortë, më i fortë se Drini, sepse atë e hapi dora e njeriut. Atëhere Drini do të mundohet ta hollojë përsëri trupin si ai gjarpëri, që kur i kanoset rreziku, futet në një vrimë shumë të ngushtë e detyrohet të tkuurret. Atëhere ai minatori, që ndoshta është babai yt apo imi, do të buzëqeshë, duke fshirë djersët me shami. Do të buzëqeshë dhe do të thotë me vete: «Kaq e pati edhe kjo kuçedër; kaq e pati dhe ky mal. Ja shpuan barkun tej përtej. Po tani? Ç'të bëjmë tani? Duhet hapur edhe një hidrocentral tjetër, duhet çarë edhe ai mali tjetër atje tutje T'i nënshtrojmë malet, lumenjtë; t'i bëjmë që të ecin sipas dëshirës sonë. . .» Dhe kjo do të ndodhë shpejt.



## U ZHDUK NJË NJOLLË

Atë ditë Besniku ndenji gjithë orët i heshtur. Vija re se ai nuk tregonte vëmendjen dhe interesin e zakonshëm për mësimin. Sytë i ishin skuqur dhe fytyra e tij e lodhur të jepte të kuptoje se diçka kishte. Kur e ngrita për të përsëritur mësimin, ai u turbullua. Ishte hera e parë që Besniku nuk ishte në gjendje të fliste: ai nuk e kishte dëgjuar mësimin, që kisha shpieguar... Nuk e qortova, i thashë të ulej. U ul në bankë i dërmuar dhe sytë i shkëlqyen nga lotët. Kur mbaroi mësimi, unë qëndrova në klasë. Edhe Besniku ndenji me mua.

— Ç'ke kështu? — i thashë.

Besniku uli sytë dhe në mes të ngashërimit më tha:

— Mbrëmë... mbrëmë më fejuan, zoti mësuës.

— Të fejuan?! — u habita unë. — Po me cilën?

— Me Fatmirën, nxënësen e klasës sonë.  
— Ajo e la fare shkollën.

U habita shumë nga kjo ngjarje. «Prandaj dhe Fatmira dje dhe sot nuk ka ardhur në shkollë? — mendova. — Kurse unë as që dija gjë për këtë.» Shqetësimi i nxënësit tim më preku thellë: Ai kishte të drejtë. Ishte në klasën e shtatë, donte të vazhdonte shkollën bujqësore. Kjo ishte dëshira e tij më e zjarrtë. Ishte nxënës i zellshëm, i zgjuar dhe me vullnet. Ai me siguri do t'ja arrinte këtij qëllimi. Por ja, një re e zezë ja mbulonte Besnikut këtë qiell të kthjellët dëshirash.

Prindrit e kishin fejuar.

— Po ti, ç'ke vendosur të bësh? — e pyeta unë padashur.

Nxënësi im ngriti kokën me vendosmëri dhe unë vura re se sytë i shndritën fort.

— Unë nuk do të bindem.

Më pëlqeu kjo vendosmëri.

— Unë Fatmirën e kam shoqe, e kam si motër, — më tha Besniku. — Edhe atë prindërit e kanë detyruar.

— Por si mendon ti? — i thashë. — A s'mundet t'i bindim prindrit e tu që të ndryshojnë këtë mendim? Besniku ngriti supet dhe tundi dorën fort në shenjë mohimi.

— S'ma merr mendja. Ata më thanë se

fjala u dha dhe më lehtë mund të përmbysset mali, se sa të shkelet fjala.

— Na do ta prishim atë, — i thashë me besim. — Ne do të na përkrahin të gjithë. Që sot do të vij të bisedoj me prindërit e tu.

— Falemnderit, — më tha. — Sido që të bëhet unë nuk do ta pranoj kurrë këtë fejesë.

Në mbrëmje u takova me kryetarin e këshillit, sekretarin e organizatës së partisë dhe të rinisë. Shkuam në familjen e Halitit, babait të Besnikut dhe biseduam gjatë me të.

— Ne kemi dhënë fjalën, — kundërshtonte i papërkulur ai. — Unë s'e turpëroj këtë mjekër të thinjur. Unë nuk bëhem gazi i botës...

— Gazi i botës je bërë duke lidhur një pazarllëk të tillë, — u nxeh sekretari i rinisë.

— Ka kaluar ajo kohë kur lidheshin fejesat që në djep, — shtoi kryetari i këshillit. — Fshati do ta thotë fjalën e tij për këtë njollë që na ke vënë...

Haliti kundërshtonte i nxehur dhe gjendja po acarohet. E shikoja se ishte shumë e vështirë të bindej Haliti.

— Po Besniku nuk e pranon këtë fejesë — ndërhyra unë. — Ai është shumë i vogël dhe ka vendosur të vazhdojë shkollën. Ti nuk duhet t'ja prishësh atij të ardhmen. Ne nuk do të lejojmë që të luhet me fatin e tij.

— Unë e kam djalin tim, e kam gjakun tim. Askujt s'i duhet të ndërhyjë në çështjet e familjes sime.

— Gabon! — Për të mendon partia, mendon shoqëria jonë. Ata do të jenë prindër për të, në qoftë se ti nuk do ta kuptosh detyrën që ke ndaj tij.

U larguam që të tre pa e përshëndetur. Haliti qëndronte me shpinën të kthyer nga zjarri dhe dukej si ndonjë div i mundur, që prapëseprapë nuk dorëzohet.

Shkuam edhe tek prindrit e Fatmires. Ata më shumë heshtnin. Siç dukej, me ta e kishim më lehtë të merreshim vesh.

Fjalët tona i bënë të mendohen thellë dhe, ndonse nuk na e thanë copë që do ta prishnin këtë fejesë, ne e kuptuam se ata do të veprojnë në kështu.

Atë natë u ktheva vonë në dhomën time. Fillova të lexoj, kur papritur dëgjova një trokitje të lehtë në derë. ... Pashë Besnikun, që qëndronte i skuqur përpara meje:

— Ika nga shtëpia, babai desh të më rrihte, kur unë i thashë se nuk do t'i bindesha kurrë për këtë fejesë. Do të shkojë te dajë Ismaili.

Unë e futa brenda. E shihja thellë në sy dhe më dukej më i pjekur se kurrë.

— Ne do ta zgjidhim këtë punë së shpejti, ti gjatë kësaj kohe qëndro këtu, me mua.

— Faleminderit.

\* \* \*

Të nesërmen në mbrëmje pothuajse gjithë fshati ishte mbledhur në sallën e vatrës së kulturës. Kishin ardhur arësimitarët e shkollës si edhe Ismaili, vëllai i Halitit, minator i vjetër komunist.

S'kisha parë ndonjëherë në fshat një mbledhje aq të gjallë, me pjesëmarrje aq të madhe. S'mbeti njeri pa folur. Folën pleq e të rinj, gra dhe vajza. Ndrojtja ishte zhdukur, ngurimi u davarit si një re tymi. Sekretari i partisë foli hapur, e tregoi ngjarjen fill e për pe dhe dënoi këtë fejesë. Për orë të tëra vazhdoi kjo mbledhje. E dënuan këtë zakon të mykur. Foli edhe Ismaili, vëllai i Halitit.

— Mua si minator i vjetër, si komunist, më vjen turp që vëllai im ta bëjë këtë gjë. Ai rrjedh nga një shtresë e varfër, vetë e di se ç'ka hequr në femininë e tij... Haliti duhet të përpiqet që ta bëjë sa më të lumtur jetën e Besnikut, të ardhmen e tij, dhe jo të shkatërrojë atë. Unë, ashtu si ju të gjithë nuk do ta lejoj një fejesë të tillë!

U ngritën pastaj prindrit e Fatmires. Ata pranuan se kishin bërë gabim duke e fejuar vajzën e tyre të vogël me një djalë po aqë të vogël. Ata dhanë fjalën se hiqnin dorë menjëherë nga kjo fejesë e pamenduar.

I fundit u ngrit Haliti. Të gjithë hesh-tën dhe kthyen kokën nga ai... Haliti s'dukej më si ai i pari: gjithë kokëfortësia dhe këmbëngulja e tij ishin rrëzuar përtokë. Balli i ishte mbushur gjithë rrudha dhe dukej sikur një barrë e rëndë ja kishte kërrusur më tepër shpatullat.

— Shokë, — filloi ai me një zë të ngjirur. — Ju folët shumë drejt, bile nuk më dënuat aq, sa duhej. Unë bëra një gabim të madh, shumë të madh, që fejova Besnikun. Por gabimi më i madh ishte se unë, edhe kur erdhën dy herë me radhë në shtëpi shokët e organizatës bashkë me mësuesit, u solla keq. Unë e kuptoja që kisha bërë gabim, por s'desha të përulesha edhe pse ishte fjala për fatin e djalit tim... Unë gabova rëndë. Tri net me radhë s'më ka zënë gjumi për këtë... Dhe të gjithë fajin e ka ky zakon i mallëkuar, që ne s'e kemi shkukur ende nga rrënjët. Ne sikur ishim qorruar para tij... Prandaj le t'ja këputim kokën që sot këtij zakoni. Le t'i varrosim gjithë zakonet e vjetra, që na kanë pi-

rë gjakun si shushunja! Le të veprojmë gjithnjë ashtu si na porosit partia!

Fjalët e Halitit i pritëm me duartrokitje. Ai na u afrua, na shtërngoi dorën të gjithëve na përqafoi dhe na tha:

— Faleminderit, shumë dhe... më falni. Atë Halitin fanatik, inatçi dhe kokëfortë, që sot, e mbyta në Devoll. Ju kam miq me kokë dhe derën time e keni gjithmonë të hapur.

— Kurse unë që nesër do ta dërgoj Fatmirën në shkollë, — na tha babai i saj, Asllani.

Të gjithë ishim të gëzuar dhe dolëm duke qeshur e kënduar nga vatra e kulturës. Por më të gëzuar ishin Besniku me Fatmirën, që bisedonin midis tyre të lumtur e të çiltër, si shokë të afërt, si vëlla e motër.

## VULLNETARI MË I VOGËL...

— Arritëm në pyjet e Tuçit të Pukës aty nga dreka.

Ishim 300 vullnetarë, nxënës të shkollave të mesme dhe studentë të Institutit pedagogjik të Shkodrës. Kur po rregullonim shtretët e fjetjes në kabanon, erdhi sekretari i rinisë e më tha:

— A e dini ç'ka ndodhur, shoku mësues?

— Çfarë? — pyeta unë.

— Këtu ka ardhur edhe një pionier. E quajnë Bashkim; Thotë se është nxënës i klases VII.

— Pse e latë të vijë?

— Ne s'dinim gjë! Është futur në maqinën e studentëve e ata, kujtuan se është pasagjer nga Puka. Ç'të bëjmë me të, shoku mësues?

— Ta ktheni që tani!

— Këtë e dimë, po qysh ta kthejmë? Ma-



qinat që na sollën kanë ikur. Nesër në mëngjez mund ta nisim me ndonjë «Skodë». Po kishte një kokë ai...

— Ma sill këtu! Edhe kjo na duhej. Kushedi sa merak janë bërë prindërit e tij tani! Duhet t'u telefonojmë patjetër. Po kush janë prindërit e tij? Po ky Bashkimi, cili është?

Pas pak e sollën djalin. E njoha menjëherë. Pse kishte ardhur këtu?

Më vështronte si i qetë, megjithse sytë dhe fytyra e tij shprehnin frikë.

— Me kë erdhe këtu? — e pyeta ashpër.

— Me studentët! — u përgjegj.

— Kushedi sa do të jetë shqetësuar babai! — i thashë. (E dija se nuk e kishte nënën). Bashkimi qeshi.

— Babai e di. Ai më përcolli sot në mëngjez. Natyrisht, e gënjeva, i thashë se më këni pranuar në brigadë.

— Ç'do të bësh në brigadë? Ti e di se pionierët s'i pranojmë.

— E di, por mendoja se mua do të më pranoni. Ç'të bëj në qytet? Veç të shkoj të lahëm përditë. Më pranoni. Ju betohem se do të jem i rregullt. Do të bëj çdo punë që të më thoni. Edhe në çetat partizane pranohej ndonjë pionier. Unë kam parë në filmin «Furtuna»...

Sytë ju mbushën me lot. Një student më tha:

— Po sikur ta pranojmë? Mënd ta caktojme për t'u sjellë ujë vullnetarëve. Ai po premton se do të sillët mirë.

Studenti kish të drejtë.

— Vërtet e di babai se ke ardhur?

— Po deshët merreni në telefon. E gjeni në kooperativën e berberëve, lokali Nr. 3.

— Mirë, po të besojmë! Do të sjellësh ujë për vullnetarët. Për gabimin më të vogël... Do të nisësh në shtëpi.

— Ju falemnderit, ju falemnderit! — bërtiti me gëzim Bashkimi.

\* \* \*

Të nesërmen, u zgjuam në orën 5 për të filluar punën. Rrugës, më shkuan sytë tek parulla «Lavdi PPSH» në shpatin përtej prroit. E lyer rishtas, e bardhë si dëbora, ajo lexohej qartë.

— Të lumtë, Zenel! — i thashë sekretarit. Studentët do të na kenë zili që u kujtuam para tyre. Por Zeneli i zymtë ma ktheu:

— Mjerisht, shoku mësues, studentët u treguan më të zotët se ne. U zgjova në orën 4 të mëngjezit për të shkuar ta lyej sipas pro-

sisë që më dhatë, por, posa dola në oborr, pa-  
shë parullën e lyer.

Ndërkaq komandanti i brigadës së stu-  
dentëve vjen tek unë e më thotë:

— Ju lumtë për parullën. E pranojmë se  
u treguat më të shkathtë.

Ne hapëm sytë nga habia.

— Pse, kush e ka lyer parullën? — pyeta.

— Ju natyrisht. Ama ai pionieri, Bashki-  
mi ishte dreqi vetë. Kur shkuam në orën katër  
për të lyer parullën, ai i kishte dhënë fund  
punës e na tha: «U zgjokeni vonë, ju studen-  
tët!».

U shikuam në sy me Zenelin. Pionieri kish  
dhënë provën e parë të një vullnetari të mirë.

Kaluan ditët njëra pas tjetrës. Ne puno-  
nim dhe tejkalonim çdo ditë normën 120-130  
përqind. Brigada jonë nuk e lëshonte flamu-  
rin e aksionit. Bashkimi, pionieri i vogël fa-  
qekuq, u bë njeriu më i dashur i brigadës.  
Vullnetarëve nuk u mungonte ujë kurrë. Me  
gjyma në duar, lëvizte nga njëra kompani  
tek tjetra, i nxiste vullnetarët, u tregonte qy-  
fyre, e ata shkuleshin së qeshuri.

Tek e shihnim ashtu të gjallë, të mirë e  
të qeshur, pyesnim shpesh veten:

— Vërtet të ketë qenë i mbrapshtë Ba-  
shkimi?

Ai kish ndryshuar shumë. Zeneli, që e kish në patronazh djalin, më tha një ditë:

— Po e mban fjalën Bashkimi. Bëtë mirë që e pranuat. Ai është bërë shumë i nevojshëm për brigadën. «Pionieri ynë, Gavroshi i brigadës», kështu e quajnë vullnetarët.

Kur në fund të javës mbledheshin të gjithë dhe brigada jonë nderohej me flamurin e aksionit, vullnetarët dërgonin Bashkimin për të marrë në dorëzim flamurin. Atë çast, ai, hijerëndë drejtohej nga presidiumi ku qëndronte shtabi. E merrte flamurin dhe pasi e valviste dy-tri herë bërtiste:

— Rroftë brigada «Qemal Stafa»!

— Urra!... — bërtisnin shkollarët.

Duartrokisnin edhe studentët dhe i shtërgonin dorën pionierit të vogël.

\* \* \*

Turni mbaroi. Ndër ata që u zbukurohej gjoksi me shenjat e sulmuesit ishte edhe Bashkimi. Edhe ai u shpall sulmues, sepse, ndihmoi që brigada të tejkalonte normën ditore.

Kur arritëm në qytet, kishin dalë për të na pritur qindra prindër dhe nxënës. Kishin dalë shumë pionierë të qytetit, të cilët duke parë Bashkimin thoshin:

— Shikoni, Bashkimi qenka shpallur sulmues!

— Dhe sa rëndë që mbahet! — thoshte ndonjë me zili.

Me të vërtetë djaloshi krenohej për shenjën e sulmuesit.

I jati i Bashkimit, kur pa djalin «sulmues», m'u afrua dhe më tha:

— Besoj se nuk ju ka turpëruar!

— Na ka nderuar. Ai është pionier i vërtetë! — ju përgjegja.

I ati më falënderoi. Ndërkaq, Bashkimi m'u afrua dhe më tha:

— Mora vesh se vitin e ardhshëm do të punojmë në hidrocentralin e Drinit.

— Ndoshta — ja ktheva unë.

— Atëhere, shenjën e dytë të sulmuesit do ta marr atje! — më tha e u largua.

E pashë tek humbi mes një grumbulli pionierësh, që e kishin rrethuar. Ata e pyesnin për diçka e ai u spiegonte me duar. Sigurisht ndonjë episod nga puna vullnetare.

## LETI

Ajo e ka emrin Violeta, por ne i themi Leti. Leta apo ca më keq Violeta, na duken emra si prej të mëdhenjsh, madje kur kështu e thërret mësuesi a ndonjë njeri tjetër, ne na vjen çudi, na bëhet sikur në këtë mënyrë emri i saj tingëllon ndryshe. Gjykoni edhe vetë, si mund ta thërresish ndryshe një vajzë me trup të hollë e delikat, me sy të kaltër e të kulluar që vështrojnë aq butë dhe ëmbël?

Letin, pra, e kemi shoqe klase. As që është nevoja t'ju them sa shumë mëson e sa nota të mira merr në çdo lëndë. Këto për të janë gjëra aq të zakonshme, sa që cilido prej nesh nuk e merr dot me mend në se mund të ndodhë ndryshe.

Ajo është e shkuar me shoqet, e urtë, po për urtësinë e saj më mirë le të mos nxitohe-  
mi.

Sivjet mësuesi i gjuhës e ka caktuar si

përgjegjëse të bibliotekës së shkollës. S'kish si të gjente nxënëse më të zellshme e më të përshtatshme për këtë punë!

Në mëngjez apo mbas dite, sa mbarojnë mësimet, atë e sheh atje, tek biblioteka. Shpërndan libra, bën shënime në një fletore të veçantë, i merr dhe i shikon me kujdes ato që sjellin lexuesit. Nganjëherë mban aty edhe ca shoqe të saja dhe i rregullojnë librat e grisura. Shpesh të krijohet përshtypja se ajo s'është nxënëse, por e caktuar me këtë detyrë.

Qëkur është bërë ajo përgjegjëse e bibliotekës, nxënësit lexojnë shumë. Pse vallë? Ndoshta më parë na vinte zor t'i thoshim në çdo çast mësuesit që të na jepte. Po kjo çështje s'mund të ndahet nga puna që bën ajo si bibliotekare. Brenda xhameve të bibliotekës ka vënë një diplomë të mikut të vogël të librit, ca fotografi të marra nga revista e gazeta që tregojnë nxënës duke lexuar, lista librash të reja.

Në këndin e librit herë pas here vë një fletore të shkruar me dorën e saj lidhur me përmbajtjen e ndonjë libri të ri, të cilin, pastaj, kush e kush ta lexojë më parë. Pa na flet edhe vetë për librat, bën recensionet.

Domosdo, këto punë s'i bën tërë vetë. E ndihmon mësuesi, e ndihmojnë edhe ca shoqe e shokë që bëjnë pjesë në aktivin e biblio-

tekës. Sidoqoftë, unë e them me bindje këtë, po të mos merrej ajo me librat, biblioteka jonë nuk do të kish patur aq punë.

Një ditë, sapo mbaroi recensionin e një libri, na tha:

— Disa shoqe të klasës sonë kanë sjellë ca libra që ja dhurojnë bibliotekës së shkollës. U lumtë këtyre shoqeve! Pa mendoni një herë: sa më e pasur të jetë biblioteka e shkollës, aq më tepër do të përhapet leximi i librit. Edhe unë do të sjell nesër dy libra!

Hej, ç'na e hodhi! E shihni ju apo jo? Të hedhur po të hedhur!

Natyrisht edhe ne mund ta bënim një gjë të tillë. Pse, vetëm çupat ishin kaq bujare për shkollën?

— Po ai që s'ka libra? — pyeti Koçua.

— Vërtet, si të bëjë ai që s'ka? — thanë edhe ca të tjerë.

— Blini — tha ajo, — ose sillni lekë, i mbajmë shënim në një listë dhe pastaj vemë në librari.

Kështu u mblodhën aq libra sa u dësh të bëhej një bibliotekë tjetër, më e madhe, së e para s'i nxinte. Atë që s'kishin libra, suallën lekë. Vetë Leti vajti në librari dhe bleu librat që na mungonin e që duheshin për leximet jashtë klase. Tërë vitin e kemi uruar, se s'vu-



ajtëm hiç për t'u përgatitur për këto lexime.

Po unë ju thashë që të mos nxitohemi për urtësinë e saj. Prisni, se do t'jua tregoj për ç'shkak thashë ashtu.

Një mbasdite ajo e kish hapur bibliotekën dhe po jepte e merrte libra duke bërë shënimet që duheshin në fletoren e saj. Si zakonisht rreth saj ishin mbledhur shumë nxënës. Secili desh të mbaronte punë i pari e shtyheshin, po ajo s'ngutej e s'mërzitej. Befas nxënësit se si u shtërnguan ca më shumë dhe njëri u përplas pas xhamit të bibliotekës. Xhami krisi e u bë copë-copë.

Veç ta shihnit si u bë ajo!

— Ç'bëni kështu, ç'bëni? E thyet xhamin, bobo! Po tashti?

Si tha kështu, u pikëllua aq shumë, sa dukej sikur do të qante.

Pastaj përnjëherë u vrenjt në fytyrë, vetullat i lëvizën me nxitim dhe ju bashkuan si një nëpërkë që bëhet gati të sulmojë.

— Turp të kini! — thirri ajo.

S'e kisha parë kurrë aq të rreptë e aq të nxehur.

Ne, të turpëruar, ulëm kokën e s'flisnim fare. Njëri guxoi e tha:

— Koçua e theu, ç'faj kemi ne? Ai që e theu, ta paguajë!

Leti e shikoi me inat atë që foli, pastaj tha:

— S'ke të drejtë kur thua kështu. Koçua e theu, po ju e shtytë. Xhamin do ta paguajmë të gjithë sa jemi këtu!

Në çast ajo i mbajti shënim emrat e ne të gjithëve, llogariti sa lekë bënte xhami dhe e pjestoi për sa veta ishim, duke futur edhe veten e saj. Asnjë s'kundërshtoi. Të nesërmen bibliotekës ja vunë të ri xhamin që kishim thyer.

Njëherë tjetër një nxënës e kish humbur librin që kish marrë në bibliotekë dhe po e gënjente me sot me nesër për ta sjellë. Ajo e kuptoi dhe i tha prerë:

— E ke humbur. Libri bën tre lekë. Sill lekët ose blije librin. Njërën nga të dyja. Më mirë blije librin, ndryshe duhet të mbajmë procesverbal.

Nga kjo rreptësi e saj e pësova edhe unë vetë. Kisha marrë një libër, e lexova dhe ja shpura që të merrja tjetër.

— Pse e ka grisur? Nuk ta pranoj dhe s'të jap tjetër! — tha ajo.

Libri vërtet e kish pak të grisur kapakun, por nuk e kisha grisur unë. E kisha marrë prej një shoku atë libër dhe asaj vetëm i pata thë-

në të shënonte që e kish sjellë ai dhe që e kisha marrë unë.

Prandaj më erdhi shumë inat.

— Nuk e kam grisur unë! — i thashë.

— Po kush, unë? — tha ajo dhe qeshi me tallje.

— Nuk e di.

— Edhe unë s'e di.

— Po të duash merre, po të duash lere këtu — dhe si ja lashë librin atje, ika jashtë.

Mirëpo të nesërmen ajo më kish vënë fletërrufe për këtë punë. «Pse i sjell librat të grisur? Pse prish rregullat e bibliotekës?» shkruante aty.

Fletërrufe? Një fjalë goje. Po sa e hidhur qenka, sa e hidhur! Dhe sidomos një fletërrufe e tillë, shkruar prej Letit!

Harrova t'ju them se shtëpitë i kemi pranë e pranë. Tërë vegjëlinë e kemi kaluar bashkë. Për vite me radhë ajo ka marrë pjesë në lodrat tona, sikur të ish djalë, ashtu siç merrja pjesë edhe unë në lodrat e tyre, sikur të isha çupë. Sa e sa herë kemi ndenjor bashkë! Madje edhe kemi fjetur të dy gushe, herë në shtëpinë e saj e herë në timen, ku na zinte gjumi, kur ishim më të vegjël. Edhe tani gjithmësojmë e rrimë bashkë.

Asnjë vajzë tjetër nuk e çmoj si atë. Ku-

rrë s'më kishte shkuar në mend se mund të ziheshim një ditë. Prandaj ju e kuptoni sa shumë u dëshpërova unë që ajo ma punoi aq keq me atë djall libër të grisur. «Pse vallë, pse? Ç'i kam bërë? pyesja veten. Po këto pyetje ja bëra edhe asaj duke m'u dredhur fjalët nga inati dhe emocioni.

— Ç'më ke bërë ti? Asgjë! — tha ajo duke ngritur supet.

— Po pse, atëhere, pse më ke kaq inat?

— S'është e vërtetë. Unë s'të kam hiç inat. E përse të të kem?

— Po... ja, e bëre të madhe atë punën e librit, sikur... më do të keqen, kurse unë...

— Unë ta dua të mirën ty, po, bëre gabim, të ndreqesh!

— Librin nuk e grisa unë!

— E pastaj? Ç'do të të gjente sikur ta kishe ngjitur e ta sillje të rregullt?

Këtu ajo kish të drejtë dhe unë u skuqta nga turpi që më kish munduar.

— Oh, sa e rreptë je! — thashë i turpëruar.

— Vërtet?

Unë e pashë drejt në sy, por shpejt ula kokën.

— Vërtet? — përsëriti ajo.

— Të dija të urtë — thashë.

Ajo u vrenjt.

— Nuk dua të jem e urtë si shqerrë —  
tha me seriozitet.

E kuptova që kisha gabuar dhe s'e zgjarta më tej. Tani kam hall veç mos më mbajë mëri. E kisha hak edhe atë fletërrufenë, mirë ma bëri. Po më vjen inat me veten time se sikur s'u tregova njeri për të qenë duke u grindur kot me të.

Tani më vjen çudi se si arrita të grindem me të.

A do të më falë vallë? më është e shtrenjtë shoqëria e saj dhe dëshëroj me gjithë shpirt që ajo të mos më mbajë mëri. Veç të mos më mbajë mëri e të shkojmë mirë e bukur si më parë! Këtë kërkoj, sepse Leti është një shoqe e dashur dhe shumë e mirë, ashtu si është edhe e rreptë, por e drejtë.

## PORTRETI

Erdhi dhe një i ri.

Kjo shkaktonte tek ne një interesim dhe gëzim të veçantë. Për ne ishte ngjarje e madhe. Na u shtua një shok.

Ardhja e Metit — kështu e quanin atë — ngjalli kureshtje të madhe. Ai ndryshonte nga të gjithë ne. Kishte diçka të veçantë. Meti nuk fliste. As nuk dëgjonte. Ishte memec.

Nuk e lamë vetëm. Secili mendohej ta mbante afër.

Meti ishte shumë i zgjuar. Dragushi filloi të merrej vesh me të fare mirë. Mësoi të shkruante emrin e tij e të shokëve. Kish kujtesë të çuditshme.

I dhanë çantë, fletore vizatimi e lapsa. Meti do të mësonte të vizatonte.

Përparimet e tij ishin të çuditshme. Mua, që mbahesha, jo vetëm si vizatuesi më i mirë

i shtëpisë së fëmijës, por dhe si më i miri i shkollës, më vinte zili për përparimin e tij.

Kishte vullnet këmbëngulës. Rrinte orë të tëra mbi fletoren e vizatimit.

Të gjithë ishin të kënaqur me Metin. Vetëm ai nuk ishte i kënaqur me veten.

Një mbrëmje, pas pushimit të parë të studimit, Meti nuk erdhi në sallë për të vizatuar. Kaluan disa minuta. Ai nuk vonohej kurrë. Drejtoresha më dërgoi ta kërkoja. Pas shumë mundimesh e gjeta hipur mbi mur. Kishte vënë blokun e vizatimit në gjunjë dhe vizatonte.

Dielli donte shumë pak që të humbiste. Retë rreth tij ishin skuqur. Ishte me të vërtetë një panoramë e mrekullueshme. Të gjithë këtë panoramë të mrekullueshme Meti e kishte hedhur në fletën e blokut të vizatimit.

Qysh nga ajo ditë ai filloi të bëhej më i zymtë. Dontë të rrinte sa më shumë vetëm.

Një ngjarje e bëri Metin shumë të qeshur.

Po afronin festat e nëntorit. Si zakonisht, nëpër muret e bibliotekës e të sallave të studimit ne varim shumë tablo të ndryshme.

Një mbasdite drejtoresha filloi të na spiegonte fotografitë e atyre tablove. Kur u afruam afër një fotografie, ku kishin dalë di-

sa partizanë, ajo na tha se me ata kishte qenë dhe babai i Metit.

Meti nuk e kishte parë kurrë babanë.

Kishte shumë nga ne që nuk i kishim parë kurrë prindërit, ose i kishim parë, po nuk i mbanim mend fare, megjithatë ne kishim dëgjuar diçka për ta. Na kishin folur të afërmit tanë, mësuesit dhe drejtoresha. Dhe ne vetë diçka mbanim mend. Po Metit, si t'i thoshin se babai i tij kish qenë trim, se ai qe vrarë për të mbrojtur atdheun, për të na bërë ne dhe Metin të lumtur?!

Në cepin e fotografisë dukej një partizan, i ulur me një gju në tokë e me pushkën para duarve. Meti ma tregonte atë partizan, sa herë që i vija pranë. Dhe unë e shikoja atë partizan me vemendje. Të bënte për vete me atë buzëqeshjen e ëmbël, me ato vetullat e trasha burrërore.

Një ditë tabloja nuk ishte më në mur. Të gjithëve na bëri përshtypje. Tek ne nuk ndodhnin kurrë gjëra të tilla.

Pas disa ditësh ja gjeta Metit brenda në këllëfin e jastëkut. Fotografia e mesit, ku ishte partizani i ulur në gju, mungonte.

Nuk i thashë askujt.

Meti nuk na vizatonte më as ne, as Lilin e vogël, që nuk e lëshonte kurrë nga duart.



Në pushim zhdukej. Nuk luante më as futboll, as volejball e as pingpong, që i kishte aq qejf.

Një natë u zgjova për të pirë ujë dhe Metin nuk e pashë në krevat. U shqetësova shumë. Ç'kishte Meti?! Pse kishte ndryshuar aq shumë?! unë ju afrova në majë të gishtërinjve. Në gotë kishte më shumë lapsa se zakonisht. Shumica me majë të harxhuar. Vizatonte me shumë kujdes. Unë njoha menjëherë buzëqeshjen dhe shikimin e partizanit, që më tregonte vazhdimisht Meti.

Ishte përqëndruar i tëri mbi atë portret. Ç'të bëja?!

Doja të lëvizja. T'i thoshja të flinte. Por ai me siguri do të më zemërohej, po ta ndërprisja nga puna.

Nuk e ngava. Ndenja dhe pak, pastaj u largova.

Të nesërmen u zgjua më vonë se zakonisht. Sytë i ishin skuqur. Duhet të kishte ndenjtur shumë vonë. Krevatin nuk e rregulloi me qejf si më parë. Hëngri bukë shpejt e shpejt dhe u largua. Në shkollë nuk shkoi.

— Ka ndryshuar shumë Meti, — i tha mësuesi i vizatimit drejtoreshës. Detyrat nuk m'i bën më si më parë.

— Çfarë ka Meti? — pyeti drejtoresha.



Unë e dija. E dija se ai lodrat dhe mësimet i kish lënë për të punuar portretin. Portretin e dashur të partizanit.

Nuk m'u durua. E nxora të fshehtë. Që atë ditë mësuesi i ndihmonte Metit për të mbaruar portretin.

Dragushi gjeti një kornizë të bukur dhe ja dhuroi.

Portretin e partizanit e vunë në murin e dhomës.

Ai na buzëqeshte sa herë hynim e dilnim nga dhoma.

Vizitorëve të jashtëm, Meti mendohej t'u spjegonte, duke bashkuar dy gishtërinjtë të regues, se ai ishte babai i tij.

Kishte të drejtë Meti. Ai ishte babai i tij. Ai ishte babai ynë. Ai ishte vrarë për Metin dhe për ne.

## **ERITROSI, LEUKOSI DHE TROMBOSI**

Babai, i Irfanit është mjek. Ai punon në laboratorin e spitalit të qytetit. Prej disa ditësh Irfani nuk e ndjente veten mirë. I ati një ditë e mori me vete në spital, i shpoi pakëz gishtin e vogël, i thithi me një tub të hollë pakëz gjak e pastaj, duke buzëqeshur me heroin e vogël që kish shtrembëruar fytyrën nga dhembja, tha: — Dhe tani të shohim ç'do të na thonë Eritrosi, Leukosi e Trombosi.


Irfani e vështroi i çuditur e si i hutuar.

— Cilët janë këta, baba? — pyeti ai.

— Janë miqtë më të ngushtë të njerëzve e sidomos të fëmijëve. Shumica e fëmijëve nuk i njeh këta miq të padukshëm, që shpeshherë, për të mbrojtur jetën e tyre, japin jetën e vet.

— Baba, s'po kuptoj asgjë, asgjë, — tha Irfani.

— Mirë, Irfan. Do të tregoj një histori



që bën fjalë për Gencin, Leukosin, Eritrosin dhe Trombosin. Ndëgjo, pra.

«Leukosi që do të thotë pa ngjyrë, eritrosi që do të thotë i kuq dhe trombosi, ndodhen në gjakun e çdo njeriu. Që të tre janë komandantë të sprovuar e trima të ushtrive të tyre të panumërta.

Leukosi është komandanti i rruazave të bardha ose leukociteve, kurse Trombosi komandanti i pllakave me fytyrë të shtypur. Komandantët me të drejtë mund të krenohen për ushtritë e tyre, që janë nga më të mëdhatë që njih historia. Në fare pak gjak, në 1 mili-

litër, ka 6000-8000 leukocite, 4-5 milion eritrocite dhe 400 mijë trombocite. Dhe e gjithë kjo ushtri në 1 mililitër gjak, një sasi fort e vogël, po në 5000 mml ose 5 litra gjak që ka trupi i çdo njeriu. Oh, do të dilte një numër kaq i madh, sa asnjëri nga fëmijët s'do të mund ta lexonte.

Kështu pra të tre komandantët e nderuar ishin ulur në tryezë, me planin e skeletit të njeriut përpara dhe diç shihnin me vërejtje. Papritur hapet dera me rrëmbim, e në prag duket një leukocit i lodhur e i djersitur. Duke marrë frymë me zor nga të vrapuarit, ai mezi mundi të shqiptojë:

— Gen... Genci ka prerë gish... gishtin. Gjaku po rrjedh si... si lu-lumë. Ai do të vdes-vdesë...

Kaq mundi të thotë ushtari trim e pa frymë u rrëzua. Të tre komandantët u ngritën më këmbë, nderuan në heshtje kujtimin e ushtarit trim, e pastaj Leukosi, duke u drejtuar nga Eritrosi dhe Trombosi, u tha:

— Shokë! Fëmia është shumë i pakujdesshëm. Para një jave vrau kokën, dhe ja tani përsëri po rrezikon veten. Megjithëse është kaqë kokëfortë, ne s'mund ta lemë të vdesë. Prandaj, ju, Trombos, merrni ushtrinë tuaj dhe drejtohuni tek gishti i prerë. Mundohuni

që me çdo kusht të ndaloni rrjedhjen e gjakut. Me çdo kusht!

— Si urdhëroni, shoku komandant. Do të bëj si më urdhëroni — tha Trombosi duke ulur kokën në gjoks në shenjë bindjeje.

Një minutë më vonë ushtria e trombociteve me në krye Trombosin drejtohej me të shpejtë për tek plaga. Kur arritën atje, trombocitet zbritën nga kuajt e me shpata të zhveshura goditën njëri-tjetrin. Nga trupat e plagosura për vdekje u rridhte një lëng i trashë, ngjitës që dalëngadalë filloi të kthehej në një rrjetë të dendur.

Pas pak rrjeta e dendur ndaloi plotësisht rrjedhjen e gjakut. Oh, ishte një ngjarje e paparë dhe e paharruar! Trombocitet kishin goditur veten me qëllim, kishin pranuar të humbisnin jetën e tyre, që të rronte fëmia, që të rronte Genci, që ndoshta n'ato çaste, kur i kish ndaluar gjaku, kish thirrur prej gëzimit, por s'kish vrarë mendjen të gjente shkaku; miqtë e kishin ndihmuar në ato çaste kritike.

Kaluan dy orë. Genci, që kujtoi se rreziku kish kaluar, në vend që të lidhte me garzë gishtin e prerë, shkoi të luante në një kanal që kishin hapur punëtorët para një jave.

Nga plaga e ndotur me baltë filluan t'i hynin miliarda mikrobe.

Me të marrë vesh këtë lajm, Leukosi dhe Eritrosi u zemëruan mjaft me Gencin që s'vin-  
te mend në kokë, por megjithatë menduan  
që fëmia s'duhej braktisur në ato çaste rreziku.

— Eritros, përpiqu me ushtrinë tënde të  
shumtë të na furnizosh me oksigjen. Kjo do të  
ndihmojë luftën tonë të pabarabartë. Një leu-  
kociti do t'i duhet të luftojë kundër 100 mi-  
krobeve.

— Lufta do të jetë e ashpër — i tha Leu-  
kosi Eritrosit.

Pa humbur kohë Eritrosi në krye të ush-  
trisë së tij u nis për në mushkëri. Çdo eritrocit  
mbushej me 02 oksigjen në mushkëri e me  
shpejtësi drejtohej për në fushën e betejës për  
të ndihmuar leukocitet.

Lufta midis leukociteve e mikrobeve të  
zeza, me trajta e fytyra të tmerrshme, t'arma-  
tosura me shigjeta tërë helm, kish nisur ë ash-  
për. Oh, ishte një luftë heroike e leukociteve!  
Luftonin me gjithë shpirt gati për të dhënë je-  
tën e tyre. Mbi një leukocit vërsuleshin 100  
mikrobe përnjëherësh. Leukociti gëlltiste dhje-  
tra prej tyre, por pastaj rrëzohej për tokë i  
plagosur për vdekje nga shigjetat e helmuara  
të mikrobeve të zeza stërrë. Leukosi ndodhej  
në rrezik. E kishin rrethuar qindra mikrobe,  
që përpiqeshin ta vrisnin, por ai nuk jepej.



Luftonte me tërbim, duke goditur sa përpara, sa mbrapa, sa anash. Dhjetra mikrobe binin të vdekur në çast nga një lëvizje e shpatës së tij. Mikrobet tmerroheshin dhe çuditëshin nga forca e tij. Disa mikrobe të frikësuara shkuan tek komandanti i tyre.

— Ka një shpatë magjike — thoshte njeri duke u dridhur.

— Ka një fuqi të tmerrshme — ja priste tjetri.

— Heshtni, budallenj, frikacakë, forca e tij nuk qëndron tek shpata e tij dhe as tek trupi i tij; tek zemra e tij, tek zemra. Në zemër ai ka dashurinë për jetën e njeriut, prandaj lufton me kaq guxim, prandaj është më i fortë se qindra nga ju. Shkëputini atij dashurinë me shigjetat tuaja të farmakosura do të shihni! — tha komandanti i djallëzuar.

Pas 10 orësh kishin mbetur vetëm 100 leukocite me komandantin e tyre Leukosin.

Përballë tyre ndodheshin miliarda mikrobe.

— Më mirë të vdesim, se sa të dorëzohemi — u tha Leukosi ushtarëve. Mikrobet po u afroheshin dalëngadalë. Ata kërkonin të zinin gjallë Leukosin.

Nuk i ndanin veçse disa hapa, kur Leukosi me ushtrinë e tij të vogël, me guxim të paparë, u vërsul mbi armiqtë.

Papritur tek armiqtë filloi një rrëmujë e madhe. Ata filluan t'ua mbathnin këmbëve, kush e kush të fshihej më parë.

Leukocitet filluan të përqafoheshin nga gëzimi e të thërrisnin.

«Urta! Urta! Urta!...

Ç'kish ndodhur?

Prindërit e Gencit e qortuan rëndë atë për pakujdesinë e tij dhe e çuan tek mjeku.

Mjeku ja lidhi plagën, e me që Gencit kish filluar t'i ngrihej temperatura, gjë që donte të thoshte se mikrobet po fitonin mbi leukocitet, ai i bëri një penicilinë. Penicilinës i tremben që të gjitha mikrobet, sepse ai i mbyt në çast.

Kështu pas dy orësh temperatura filloi të ulet. Trupat e leukociteve, që kishin dhënë jetën për Gencin, filluan të prisheshin e të ktheheshin në qelb.

Ja pra kush e formon qelbin.

Kështu, pas disa ditësh Genci u shërua plotësisht».

— Ja pra, Irfan i vogël. Ky qe tregimi im. Të pëlqeu?

— Po, baba. Unë sot njoha miq të rinj që nuk i dija më parë...

— A don t'i shohësh me sytë e tu, Irfan?

— Po baba, dua.

— Eja me mua.

Të dy u drejtuan tek një aparat, që e quajnë mikroskop dhe që një fie floku e bën të duket sa një laps, kaq shumë zmadhon.

Irfani pa me mikroskop dhe njohu për të parën herë miqtë e shtrenjtë e të «padukshëm» të njeriut dhe u premtoi se miqve të tillë, si Leukosi, Eritrosi dhe Trombosi ai s'kish për t'u nxjerrë kurrë telashe, ashtu si Genci.

## DASHURI NXËNËSI

Dhjetori i vitit 1950. Isha arësimtar në një fshat të vogël të Myzeqesë. Pranë fshatit kalonte Vjosa. Sa i bukur është lumi në verë! Retë pasqyrohen në të dhe aq të qarta janë, sa që duken si tufa patash. Ama në dimër, Vjosa bëhet e egër, fryhet e gjëmon si ata djajtë e përrallave.

Shkolla ishte në mes të fshatit, në një kodër të rrethuar me bajame dhe kumbulla të mëdha. Më kujtohet si tani se si ndodhi kjo, që do t'ju tregoj më poshtë.

\* \* \*

Atë ditë dhjetori u ngrita më vonë se herët e tjera. Frynte erë e ftohtë dhe dielli dukej e zhdukej mes reve. Hyra në klasë dhe fillova mësimin. Atë orë kisha histori.

— Kush nuk është përgatitur? — pyeta klasën.

Nuk u përgjegj asnjëri. Vështrova me kureshtje fytyrat e nxënësve. Pastaj thirra Bardhylin. Bardhyli ish i gjatë dhe i mbushur, kish trup të madh për moshën e tij, si nxënës i klasës së katërt që ishte.

— Folë për kthimin e Skënderbeut në Shqipëri!

Bardhyli u përtyp, kaloi pështymën, diç tha nëpër dhëmbë dhe pastaj uli kokën.

I përsërita edhe një herë pyetjen, pastaj shkova te dritarja. Qielli ish bërë sterrë i zi. Filloi të bjerë shi i rrëmbyer i shoqëruar me gjëmime të njëpasnjëshme. Bajamet lëkundeshin e sa s'tyheshin nga era e fortë.

U ktheva nga klasa. Bardhyli rrinte ende me kokë të varur. E ula në vend.

— Kësaj radhe po të vë dysh. Ki mendjen se do të ngre radhën tjetër.

Pa mbaruar së foluri, jashtë u dëgjua një zhurmë e madhe. Shkova me të shpejtë te dritarja. Një bajame ishte thyer. Sakaq nga fshati u dëgjua një britmë.

— Rrini urtë! — u thashë nxënësve. — Po shkoj të shoh se ç'po ndodh dhe do të kthehem shpejt.

Dola. Britma u përsërit edhe një herë

tjetër. Fillova të rend në drejtim të saj. Këmbët më shkisnin, kostumi m'u bë me baltë. Sakaq dola në breg të lumit. Vjosa kish vërshyer nga shtrati. Uji i turbullt gjëmonte dhe vinte rrotull me një zhurmë të tmerrshme. Shkova më tej. Rreth një shtëpie ishin mbledhur shumë njerëz. Një grua shkulte flokët dhe bërtiste. U afrova. Shtëpia ish përmbytur nga ujët. Ndërkaq lumi po fryhej më tepër. Në mes të ujit dallova një send që lundronte. Atë e panë edhe të tjerët. E pa edhe gruaja, që shkulte flokët, e cila nisi të ulërijë më shumë.

— Korba, korba! Fëmija! Po më mbytetet fëmija!

Unë u ngjetha. Ai send ishte djepi me fëmijën brenda, të cilin nga rrëmuja e përmbytjes njerëzit e kishin harruar në shtëpi.

— Korba! Fëmija!

— Po mbytet!

M'u errën sytë. Nuk e kuptova as vetë se si u hodha në ujë. Djepi lëvizte ngadalë. Nisa të shkoj me not drejt tij. Rrobat më pengonin. Djepi donte dhe nja dy metra të shkonte në lumë. Nisa të shpejtoj. Njerëzit nga bregu më thërrisnin:

— Kujdes, mësues!

— Edhe pak se e arrite!

— Ububu! Do të mbytet edhe mësuesi, edhe fëmija.

Krahët m'u lodhën. Më në fund e arrita. Foshnja ishte lagur pak, por ishte mirë. Ndërkohë dikush më hodhi një litar. E kapa dhe lidha me të djepin. Nga bregu na tërhiqnin. Shiu ende binte me rrëmbim. U lodha. Ndjeva se kisha pirë shumë ujë. Duart më shkanë nga litari dhe mbeta i vetëm mes ujit të turbullt. Rryma ish e fortë dhe më rrëmbeu me vete drejt lumit. Fillova të mos mendoj më, duart i përplasja kuturu. Kur kisha humbur çdo shpresë, një zë, që m'u duk shumë i largët më thirri:

— Zgjatani dorën dhe kapuni pas meje, mësues!

Vetvetiu e zgjata dorën. Ndjeva se dikush më preku dhe pastaj humba ndjenjat.

\* \* \*

Kur të nesërmen hapa sytë, pashë mbi kokë një infermiere. Ajo buzëqeshi dhe më foli:

— E? Si e ndjen veten?

— Mirë.

Infermierja u largua. Unë u përpoqa të

sjell ndërmend atë që kish ndodhur një ditë më parë. Në vesh ende më buçisnin ato klithmat e djeshme:

«Korba! Korba! Fëmija!»

U përpoqa të mbyllja sytë. Më kot. Truri më rrihte fort. U ktheva nga ana tjetër. Dhe kështu për një kohë të gjatë nisa të përpëlitem në shtrat.

U ngrita. Shkova në dhomën e infermierës dhe e para fjalë që i thashë ishte:

— Fëmija, si është fëmija?

Ajo përsëri buzëqeshi dhe m'u përgjegj:

— Shëndoshë, si kokrra e mollës.

Pastaj si heshti ca, më tha:

— Një djalë ka ardhur pesë herë deri tani, por nuk guxon të hyjë brenda. Sa pyet dhe largohet. Tani është aty jashtë. Hapa dritaren. Në oborr mbështetur pas murit, qëndronte Bardhyli. I bëra shenjë të hynte në infermjeri.

Ai erdhi kokëulur. Në fytyrën e skuqur dallova disa bulëza djerse.

— Kam ardhur t'ju shoh, — tha me nxitim. — Si jeni tani? — Pastaj, pas një hopi, shtoi:

— Sot kishim prapë histori. Ju më premtuat se do të më ngrinit, por meqenëse ndo-



dhi ajo e djeshmja, unë erdha të më pyesnit këtu në spital.

Fillova të çuditem me të. I thashë të shkonte në shtëpi, por ai nuk tundej. I thashë se e besoja. Ai rrinte kokëvarur dhe nuk lartgohej. Më besoni, nuk u largua deri sa e pyeta.

— Shumë mirë, Bardhyl, të lumtë! Ke mësuar për dhjetë.

\* \* \*

Kur dola nga spitali, mora vesh se shpëtimtari im ishte Bardhyli. E thirra një ditë kur mbaroi mësimi dhe, pa i thënë asnjë fjalë, e rroka në krahë. Dhe ai si të ish ndonjë i madh, filloi të belbëzojë në krahët e mi.

— Bëra detyrën karshi mësuesit. Ju shpëtuat një foshnje duke rrezikuar jetën. Edhe unë u hodha t'ju shpëtoja juve.

— Po unë atë ditë të vura dysh në histori, — ja prita me shaka.

Ai u shkëput nga unë, tundi kokën duke qeshur dhe u largua me vrap për t'u bashkuar me shokët e tij.

## ARTANI

Zilja lajmëroi fillimin e orës së fundit të tremujorit. Në klasë qetësi. Kjo orë vendoste në se do të mbahej premtimi i dhënë. Pse ishin kaq të shqetësuar nxënësit e klasës V? Çfarë premtimi kishin dhënë ata?

Para tre muajsh, ata ishin zotuar se do të kalonin të gjithë klasën. Ishte zotuar edhe Artani. Shokët s'kishin shumë besim. Artani nuk ishte njeri me vullnet të fortë. Në lëndë të ndryshme shkonte mirë, sidomos në aritmetikë. Në histori çalonte. Edhe në tremujorin e parë kishte mbetur. I ishte mbushur mendja se nuk e mësonte dot historinë. Shokët e këshillonin, shpesh humbisnin durimin. Ai e ndjente veten më të qetë, kur ata largoheshin. Vetëm me Agronin i shkonte ca muhabeti.

Erdhi fundi i tremujorit. Vetëm Artani rrezikohej për të mbetur.

...Mësuesja e historisë hodhi një vështrim mbi nxënësit dhe pa fytyrat e tyre të shqetësuara. Ajo e dinte zotimin që kishin marrë. Mbasi i hodhi një sy regjistrit, ajo vështrroi Artanin. Ky ishte ulur në bangën e fundit, ishte shumë i qetë. «Po sot, a do ta ketë mësuar mësimin?»

Mësuesja mbasi u mendua pak tha: — Hajde Artan!

Shokët psherëtinë të gëzuar. Mësuesja po i jepte edhe një herë mundësinë për të kaluar bashkë me shokët. Artani u drejtua tek dërrasa e zezë.

— Artan, na folë mbi shtetin skllavopronar të Spartës, pozitën gjeografike të tij dhe popullsinë.

Artani, që donte më mirë të mos e kishin luajtur nga banga, filloi të fliste si me përtesë. Shokët e kuptuan se ai ishte i papregatitur. Spartën e ngatërroi me Athinën, luftrat spartane i ngatërroi me luftrat e faraonëve të Egjiptit. Mësuesja e ndërpreu. I bëri një pyetje tjetër. Edhe kësaj ai nuk ju përgjegj. Mësuesja e shikonte me keqardhje. Ishite i dyti tremujor që mbetej në histori.

Sa u hidhëruan shokët e tij. Atyre u vinte keq jo vetëm për premtimin që nuk e mbajtën, por edhe për shokun që tashmë rre-

zikohej të përsëriste edhe një herë klasën.

Zilja lajmëroi mbarimin e mësimit. Në klasë edhe mbasi doli mësuesja mbretëronte qetësia. Të gjithë vështronin Artanin; kush me inat e kush me keqardhje. Ai nuk i duroi dot këto vështrime, u ngrit dhe ju drejtua shokëve me inat:

— Ç'keni që më shikoni kështu?! — Pa u lënë kohë që të flisnin ai u largua me duar në xhepa. Si kaluan disa çaste, pionierët filluan të flisnin të zemëruar.

— Ai s'e meriton emrin pionier, — u hodh Luljeta.

— Prej atij humbëm zotimin!

— Ne po humbasim një shok, tha Zana.

Biseda rreth Artanit zgjati shumë. Një pionier, Agroni, duke përfituar nga heshtja, shtoi:

— Ju folët të gjithë, por asnjë nuk na tregoi se si duhet të veprojmë me Artanin. Unë do të mundohem ta ndihmoj. Ju të gjithë e dini se ai, nuk është djalë i keq, por vetëm se është kokëfortë. Artani ka mundësi ta mësojë historinë. Në lëndët e tjera ai merr nota të mira.

Të gjithë e dëgjonin me vëmendje. Ata, pak kohë më parë, mendonin se ishte e pamundur të punohej me Artanin, kurse tani,

duke dëgjuar arsyetimet e shokut të tyre, çdo gjë sikur u bë më e lehtë, më e qartë.

• \* •

Agroni e filloi detyrën e tij të vështirë me guxim. Që atë mbasdite shkoi në shtëpi të Artanit. E gjeti duke u marrë me një palë këpucë sporti (Artani çmendej pas lojës me top). Agroni u ul pranë tij dhe filloi të merrej edhe ai me këpucët. Pasi kaluan disa minuta në heshtje, ai e pyeti:

— Për çfarë i do këto këpucë, Artan?

Ai nuk ju përgjegj menjëherë, i hodhi një vështrim dhe duke pulitur sytë me dinakëri, tha:

— Nuk e di ti? Për ndeshjen!

— Po Artan, e di që midis klasave të shkollës sonë do të zhvillohet një kampionat i vogël futbollit dhe që klasa jonë ka formuar një skuadër, ku ti, nuk merr pjesë, megjithëse je lojtar i mirë.

— E pse? — pyeti Artani i çuditur.

— Se ne të dy kemi diçka tjetër përpara, kemi historinë, — ju përgjegj Agroni me qetësi. Artani u hidhërua pa masë që shokët e kishin dënuar në atë mënyrë. Thellë në

shpirt ai e ndjente që kish gabuar, që kish turpëruar veten dhe shokët e tij, por kokëfortësia s'e linte të ndrronte rrugë.

Dy-tri ditët e para të dy shokët nuk ndaheshin. Agroni shpesh e ftonte në shtëpi të tij, i jepte libra të ndryshëm për të lexuar apo shkonin në kinema bashkë. Brenda kësaj kohe ata u bënë miq të ngushtë. Artani e donte shumë. Një ditë Agroni erdhi që në mëngjes dhe i tha: — Sot do të luajmë futboll me klasën e VII. Në skuadër je dhe ti, por paradite që të mos na shkojë koha kot, mësojmë historinë. Artani pranoi me gëzim. Në fillim e pati zor, por më vonë u mësua.

Kështu vepruan edhe në ditët që pasuan. Brenda një kohe të shkurtër, ai e zotëroi shumë mirë historinë. Ai qeshte, shikonte me mirënjohje Agronin dhe thoshte:

— Ja dhe historia s'qenka aq e vështirë sa e kujtoja!

Tremujori i tretë filloi por as Artani, as shokët e tij tashmë s'kanë frikë. Ata janë të sigurtë se premtimin e dhënë do ta mbajnë.

## PALUSHI

(Tregim humoristik)

Ju nuk besoj ta njihni Palushin. Ndoshta mund të keni dëgjuar për të. Sidoqoftë, po ju them se Palushi jeton diku, në një fshat. Sa çamarrok është Palushi!

Nga trupi vjen i shkurtër, por ama është i fortë. Sytë i ka të vegjël, të rrumbullakët e plot gjallëri. I zgjuar nga natyra, Palushi shkon mirë me mësim, e mësuesja është e kënaqur nga kjo anë.

Kur vijnë pushimet e verës, atij s'i zë këmba dhé. Gjithë ditën Palushin e sheh duke bredhur korijshe bregut të lumit ose në pyll. Ndër shokët, mbahet si trimi më i madh, si notari më i fortë dhe si gjahtari më i përpiktë.

Për trimërinë e tij Palushi ka thurur le-

gjenda! Ai është gati të betohet përsëri se ka kaluar një natë vetëm në pyll kur i kishte humbur një dele. «Qëndroja majë një pishe — u rrëfen Palushi shokëve. — Përreth dëgjoheshin hungurimat e ujqërve. Bufi «pëlliste» me zërin e tij rënqethës. Nata ishte pus. Ndërsa unë, i vetëm mes errësirës, mes pyllit, mes ujqërve!» E sa për çështjen e notit, Palushi as që dyshon se edhe detit mund t'i bjerë mespërmes...

Të gjithë shokët e dinë se Palushit i pëlqen pa masë gjuetia. Dhe po ta pyesish: «Palush, ku ishe dje?» «Isha në lumë për të zënë peshq. Ah! I kam rënë mirë qarit dje!»

— Po sot?

— Sot?!... Hë! Sot kam zënë gardalina në prozhme. S'më eci fati, zura vetëm shtatë!..

— Po nesër, Palush, ku ke ndërmend të shkosh?

— Në qoftë se koha do të mbajë mirë, do të vete në pyll për lepuj!..

Babai i Palushit është gjahtar i mirë. Ai ka një çifte dhe një zagar pullali me lesh të dendur. Ky është një fat i madh për Palushin! «E pse jo?! — arsyeton ai — për derisa janë të babait tim, janë edhe të miat!»

Kështu pra, ky «gjuajtës i përpiktë», i pa-



isur me të gjitha mjetet e një gjahtari, del shpesh për gjah. Dhe sa vret pa! Herë lepuj, herë shapka, herë turtuj... Me një fjalë nuk ndahet kurrë pa gjë! Madje një herë ka plagosur edhe ujk!.

Të tilla përralla u thotë shokëve Palushi. Ata nuk ja prishin nganjëherë, po kur i mërzit shumë i largohen. E kush ka kohë të dëgjojë «përrallat» e Palushit! Kur fillon ai, nuk di të mbarojë! Le pastaj, sa zemërohet, po të mos ja besosh «heroizmat»! «Heroizma»?! Eh Palush, Palush!

\* \* \*

Dielli po ulej prapa kodrave të fshatit, frynte një erë e lehtë; pemët shushurinin; harabelat cijasnin me gjallëri. Kooperativistët po ktheheshin nga arat. Për pak do të binte muzgu.

Në një orë të tillë, Palushi e kishte zakon të kthente kopenë nga kullota. Do ta shihje gjithnjë atë në fund të kopesë me një thupër të hollë shelgu. Po sot Palushi ishte kthyer më herët. Në dorë nuk kishte thuprën e shelgut, por një litar 2-3 metrash me të cilin kish lidhur diçka të zezë... Palushi e

kishte tërhequr zvarrë atë «diçka» gjer në mes të fshatit.

Një grumbull fëmijësh u mblohdën rreth Palushit. Lajmi se Palushi kishte vrrarë ujk, u përhap në gjithë fshatin. Fëmijët rendnin si veriu duke grishur edhe ata, që ende nuk kishin mësuar lajmin. Grumbulli bëhej gjithnjë më i madh Palushi rrinte i kapardisur mes fëmijëve me sytë e ndezur si prush dhe me veshët e skuqur si lafsha e gjelit. Palushi, trim i trimave, notari dhe peshkatari i përmendur, gjahtari zulmëmadh, ngazëlleu sot përpara shokëve, i bindur se kishte korrur sukses të plotë. Dhe vërtet sukse si qe i madh!... Fëmijët rrinin të shtangur. Palushin e shikonin me frikë dhe admirim. «Hë, s'është shaka të vrasish një ujk!» — i thosi njëri-tjetrit. Të vegjlit thërrisnin: «ujku! ujku! Ujku!» Ata veç kishin dëgjuar për ujkun, po kurrë s'e kishin parë me sytë e tyre.

Ujku, që kishte vrrarë Palushi, ishte sa një qen stani. Qimet i kishte të murrme dhe të ashpra. Dy këmbët e para i rrinin të varura; duket se i kishte të thyera. Nga goja gjysëm e hapur i shquheshin dhëmbët e mprehtë si brisku. Duhej të kish qenë plak.

— Na thua, o Palush, si e vrave? — e pyesnin shokët.

— Si e vrava? Eeeee! si e vrava, thoni ju... Hoqa shumë, vërtet hoqa shumë, por ama s'e lashë të më shpëtonte... — u përgjigjej Palushi shokëve. Herë pas here ai tundte bishtin e trashë të ujkut me një çomange që mbante në dorën e djathtë.

— Me çifte e vrave? — e pyeti përsëri djali i Ndrekos.

— Me çifte thua?! Po me çifte mund ta vrasë kushdo. Pse mos është ndonjë punë e vështirë; shkel këmbëzën, «bam!» bën çiftja dhe ujku bie këmbë përpjetë. Rri ti, Lipe, rri se nuk merr erë nga këto punë.

Djali i Ndrekos uli kokën i turpëruar. Por kureshtja e fëmijëve nuk mund të mbaronte me kaqë. Rroku, që mbahej si shok i afërt i Palushit, ju afrua ngadalë, e duke i vënë dorën në sup, i tha: — Besa, i madh paska qenë, Palush. Duhet ta kesh pasur të vështirë...»

«Të vështirë. Ja, mbani vesh, do t'ju tregoj. Po ruaja bagëtinë tek luadhi i vogël, buzë pyllit. Isha shtrirë në bar dhe po latoja trupin e çomanges me biçak. Papritmas detet filluan të blegërijnë. Ngrita kokën: nga pylli po turrej si shigjetë një ujë i murrmë...»

— Po, ti, u trembe? e pyetën njëzëri fëmijët.

— U tremba ca në fillim — vazhdoi Palushi — Ujku çau në mes të kopesë. Unë u ngrita si rrufe. Në kohën, kur ujku po i hidhej një deleje, një të vërtitur përsëri çomangen dhe «bam! e bam! e bam!» mbi kokën e ujkut. Pasi e zhdëpa mirë në dru duke i rënë në kokë dhe kurriz, fillova ta godisja edhe këmbëve. Ja shikojeni, ja theva të dy këmbët e para. Atëhere mora litarin dhe...

— Ç'bëni aty o kalamaj? — u dëgjua një zë burri. — Të gjithë kthyen kokën, ishte xha Hasani. Përmes një shtegu që i hapën fëmijët, xha Hasani ju afrua ujkut qetë-qetë duke thithur llullën. Pastaj i shikoi të gjithë në sy dhe ndali vështrimin tek Palushi. Palushi uli kokën.

— Ti e solle këtë në fshat? — e pyeti xha Hasani duke treguar me shenjë nga ujku.

Palushi nuk ju përgjegj.

— Turp! turp të të vijë — vazhdoi plaku pas pak.

— Pse o xha Hasan, Palushi e ka vrarë ujkun! — u hodh Rroku.

— Ç'e ka vrarë more! Nuk e sheh se ka nisur të mbajë erë; ky ujk ka sëpaku tri ditë që ka ngordhur. Merreni o çuna dhe hidheni këtë ngordhësirë në ndonjë qoshe!... — Pasi

tha këto fjalë, xha Hasani mori udhën përsëri duke tundur kokën.

Në turmë u dëgjuan murmëritje. Pas pak, dikush qeshi nën buzë, një tjetër qeshi me zë, qeshi dhe një i tretë dhe pastaj të gjithë kalamajtë ja dhanë gazit.

— Ama, trim paska qenë edhe Palushi!  
— guxoi e tha Rroku.

— Le! pa një të vërtitur çomangën dhe «bam!» mbi kokën e ujkut!.. — ja priti Lipja.

— Dhe pasi e zhdëpi mirë e mirë në dru, na zhdëpi edhe ne duke na gënjer — u dëgjua një tjetër. Ngado shokët e tallnin dhe e qortonin Palushin.

— Gënjeshtar! — i thirri Merushja.

— Jooo! s'është gënjeshtar! pasoi Zefi — E si mund të gënjejë Palushi kur ka fjetur një natë vetëm në mes të pyllit, kur i bie detit mespërmes!

Kaq duhej. Palushi s'mund të duronte më. Kokë varur dhe me zemër të thyer u nis për në shtëpi.

Tri ditë ndenji mbyllur Palushi: tri net pothuaj i kaloi pa gjumë. Mendonte vetëm shokët. Sa i vinte turp t'u dilte përpara!

«Ç'm'u desh që mōra nga pylli ujkun e ngordhur?» thoshte me vete. Sa budalla jam! Sikur nuk do ta kuptonin të tjerët. Le, po edhe

sikur të mos e kuptonin, çfarë do të fitoja nga kjo? Palushi ndjehej i penduar. Një herë, që t'i shpëtonte këtij turpi të madh, i shkoi ndërmend që të thoshte: vërtet, ujku që i ngor dhur, por ama ishte pikërisht ai që kisha plagosur dikur në pyll...

Por as kjo nuk i pëlqeu... Që t'i shpëtonte një gënjeshtre duhej të përdorte një gënjeshtër tjetër, kurse Palushi nuk donte të gënjente më. Jo, nuk do të gënjente. Atij nuk i pëlqente më lavdia e pamërituar. Palushi kishte vendosur të bëhej i mbarë.

Dhe vërtet, thonë se që nga ajo ditë, Palushi nuk ka gënjyer më.

## GUXIMTARËT E VEGJËL

Ishte dimër dhe kish disa ditë që binte shi. Po pastaj shiu sikur u pre dhe qielli u kthjellua. Filluan ngricat, po nuk zgjati shumë kështu. Një mbrëmje nga qielli i vrejtur, që kish marrë një ngjyrë të turbullt plumbi, nisën të derdhen flokët e parë të dëborës. Binin lehtë-lehtë si copëza letre; në fillim më të imta, pastaj më të mëdha. Qielli ngjante si një fushë e madhe që hidhte tatëpjetë miliona boçe pambuku.

Shtëpia e Tomorrit dhe e Benit ishte larg qendrës së fshatit, ku ngrihej shkolla. Duhej pothuaj një gjysëm ore që të arrije atje. Kjo e vështirësonte vajtjen në orarin e caktuar, sidomos në këto ditë të ftohta dimri, kur delnin përrenjtë tamam, si lumenj. Mësuesi e dinte këtë dhe nuk u thoshte gjë fëmijëve. Po rrallë kish ndodhur që ata të shkelnin orarin. Ishin nxënës të rregullt dhe mësonin mirë.

Tërë atë natë dëbora nuk pushoi së rëni. Në mëngjez, kur u zgjuan nga gjumi, fëmijët u habitën me pamjen, që shtrihej rreth e rrotull. Ngado që të hidhje sytë, shihje vetëm bardhësi. Dhe ende qielli ishte i vrejtur. Binte shi me dëborë.

— Si të bëjmë? — pyeti Beni i vogël, të vëllanë e tij, Tomorrin.

— Duhet të nisemi, patjetër — u përgjegj Tomorri.

— E si të nisemi?! Ti e sheh që sot s'kalohet. As burrat s'çajjnë dot e jo ne, biçirukët.

— Jo, do të çajmë se s'bën. Ti e di, sot kemi takimin me oficer Brahon. Ai do të na flasë për luftën që është bërë tek rrepet.

— Po, do të na e falin kësaj radhe.

— Jo, Beni, kot ngul këmbë. Duhet të nisemi. Unë kam për të kënduar dhe në fund do të recitoj vjershën: «Ra një trim». Mëshuesit i dhashë fjalën. Unë po iki, ti po deshe, rri.

— Jo, edhe unë do të vij — shtoi Beni i skuqur.

— Kujdes bijtë e nënës, se përroi duhet të ketë shumë ujë. Po e patë se s'kalohet, kthelhuni.

— Mos ki frikë, nënë! Ditën e mirë! — shtuan ata njëzëri. Dhe u nisën drejt e për në shkollë. Herë-herë dëbora u arrinte gjer



në gju. Po dalëngadalë ata, duke çarë me forcë përpara, e duke i dhënë dorën njëritjetrit, kaluan bregun dhe ju afruan përroit. Ai buçiste si i zemëruar tatëpjetë.

— Mbahu, Beni! — e këshilloi Tomorri.  
— Bie shi dhe rrëshqet kur të duash. A ke ftohët?

— Jo, po ti?

— Pak. Hajt të bëjmë ca lëvizje, të nxe-hemi. Po librat ku i ke futur?

— Në gjoks. Më jep pak dorën!

Përroi kish kërcyer tejpertej. Valët e turbullta rrëmbenin me vete gurë, trungje e gjithfarë shkurresh. Ujët kish marrë një ngjyrë midis kafes dhe së kuqes. Ai gërryente me forcë të dy anët e bregut.

— S'kalohet! — tha Beni. Tomorri heshti.

— Prit — shtoi dhe mbasi eci nja dhjetë metra përpjetë, u kthye përsëri.

— Ecim më poshtë? Di unë një vend më të mirë. Dhe bënë më poshtë.

— Tomi, qysh tha mamaja? Po pati shumë ujë, kthehuni.

— Ec tani, mos u bëj frikacak.

Ai kërkoi diçka nën dëborë dhe zbuloi një dru të trashë e të gjatë, gdhendur nga të katër anët në formë katërkëndëshi.

— E kemi lënë një ditë me babanë, —  
tha Tomorri — Zëre ta tërheqim bashkë.

E kapën dhe, me vështirësi, duke e hequr zvarrë, ju afruan përroit. Ishin njomur shumë, sidomos nga këmbët dhe nga supet. Ecnin. Druri qe i rëndë për duart e tyre të njoma.

— Po ç'do të bëjmë tani me këtë.

— Ja, do ta hedhim matanë si urë. Jepi! Forca! Ngrije nga kjo anë. Në fillim do ta mbështetim tek ky lisi.

— Hooopaa! Ah, s'u ngritka i shkreti! Edhe një herë, hooopaa!

— Zuri mirë, — qeshi Beni.

— Prit tani të hipi lart — tha Tomorri. Dhe ju qep si ketër lisit. Menjëherë u gjend në degët e trasha, ku ish mbështetur maja e drurit të ngritur më këmbë. Fundi kish zënë vend mbi një gur të madh buzë përroit.

— Ruh, Beni! — Tomorri e shtyti me sa forcë që pati. Druri u anua në drejtim të bregut tjetër dhe zuri vend si urë mbi përrua. Ujët e prekte po nuk e rrëmbente dot, se brigjet qenë të larta.

— Po ti qenke mjeshtër, Tomi!

— Kalojmë tani?! — shtoi i vëllai. — Do të ecim siç kemi ecur mbi trarin e ekuilibrit në shkollë.



— Shko ti i pari! — tha Beni si me drojtje. — Kujdes mos të merren mendtë. Ata kaluan të dy. Tani gjendeshin në bregun tjetër.  
— Shpejt të arrijmë para orës tetë.

— Sa për fiskulturën, shokët s'na thonë gjë. Sot e bëmë si kurrëndonjëherë tjetër, — tha me krenari Beni. — Ti je i fortë dhe i guximshëm, Tomi, — vazhdoi me seriozitet.

— Edhe ti — shtoi i vëllai dhe i rrahu shpatullat. — Veçse ti je më i vogël. Dhe unë kam besim se do të bëhesh shumë më i guximshëm.

Të dy qeshën. Ishin shumë të gëzuar. Matanë, majë malit, po çelte dielli. Dukej sikur ai i përshëndeti fëmijët.

## STUHIA

Yjet kishin çelur në qiell dhe hëna kish kohë që shpërndante dritën e saj të zbardhëlyer. Atë kohë dikush nga fëmijët tha:

— E prishim?

Zhurma tërë bujë sikur u pre.

— E prishim, e prishim, — u dëgjuan si përgjigje zëra të tjerë — nesër do të ngrihemi shpejt.

Djemtë u çuan. S'kaloi shumë dhe në çair u platit qetësia, të cilën e prishte më të rrallë zilka e ndonjë kali.

Të gjithë bënë për nga shtëpitë, veç dy vetë, të cilët u shkëputën veças, u ndalën pas kopshtit të shkollës.

Ishte Hodua dhe Çaçi. Të dy shokët ndenjën deri vonë.

Pastaj i thanë «natën e mirë» sho-shoqit dhe u larguan edhe ata.

Dielli ish ngritur lart, kur të dy dolën nga fshati. Ndenjën një çast, dëgjuan edhe një herë zhurmën që vinte nga lëmenjtë, pastaj shpejtuan çapat. Në dorë kishin nga një trastë të vogël, ndërsa mbi sup zgjatej gjer tej një kallam i gjatë e i hollë.

— Ja shkëmbi, po zbardh, — i tha Ho-  
dua shokut.

— Do edhe ca, — ja ktheu ai.

— Sa të vemi ne, zhduket hija fare.

Pastaj bënë një copë rrugë pa folur me njëri-tjetrin. U ndalën tek ca dardhë. Pemët ishin ngarkuar me kokrra të verdha. Aq shumë kishin ato dardhë dhe aq shumë ishin pjekur, sa, edhe puhia më e imtë të rrëshqiste degëve të ngarkuara, shkëputeshin kushedi sa kokrra. Ndaj zverdhonte dheu përreth. Ndërkohë mbi kryet e tyre ndali shpejtësinë një shpend dhe nga dardha ranë poshtë një grumbull kokrrash. U çuan. Në një vend ndrruan rrugë. Herë pas here ndalnin, duke shikuar atë grumbull dardhësh, që po kalbej për-tokë.

— Gjynah! — tha njëri.

Tjetri shikonte dy breshka që kafshonin të qeta kokrrat e dardhëve.

— Sa lekë humbet kooperativa!

— Ka shumë punë tani.

Dhe nisën përsëri atë udhë të humbur, që herë pleksej nëpër cfaka e herë të çonte përmes ca gjembave të kërleshur me ferrat.

Përreth dukej sikur digjej diçka. Sikur digjej bari i përzhitur, sikur digjeshin demetet e grurit, sikur digjeshin shkëmbinjte, sikur digjej balta. Ashtu u dukej atyre, se përreth ajri hidhte valle si në një flakë e ndëzur pa ngjyrë. Dita dukej e bardhë, e bardhë, e bardhë, pa lëng. Edhe ai pak ujë i lumit që rrëshqiste ngadalë nëpër gurët, ishte i vakur.

— Sikur të binte një shi i mirë! — tha

Çaçi.

Ata ranë në fund të asaj kodre. Hynë në një orman rrepush, tështitën disa herë dhe dolën në anë, tek zbardhte shtrati i lumit.

— Nuk ndihet fare zhurma e ujit! — tha njëri.

— E ku ka ujë!

U zhveshën. Fshehën rrobet në një vend dhe hynë në lumë.

— Nga do t'ja fillojmë? — i tha Hodua shokut.

— E fillojmë që nga dhësi? <sup>1)</sup>

---

1) Digë e vogël, që bëjnë fshatarët, për t'i kthyer drejtimin ujit.

Shpejtuan poshtë. E ndalën hapin atje ku ishte ndërtuar dhësi. Atij pak uji që sillte lumi aty, i qe ndryshuar drejtimi. Burrat e fshatit kishin punuar disa ditë që të ndërtonin një dhës të mirë. Se lumi kish pak ujë. Andaj duhej pikuar, duhej që i gjithë uji të shkonte në arat e kooperativës. Po megjithatë gjethet e misrit ishin përthyer, ishin zverdhur nga vapa e madhe. Ai ujë ishte shumë i pakët. Po të vazhdonte koha kështu...

— Hodo! — thirri papritur Çaçi. — Hodo! — thirri përsëri, — eja të shohësh.

— Fole gjë?

— Shiko si e kanë bërë dhësin.

Të dy djemtë ndenjën buzë krothit, që ngrihej përmbi ujët e qetë të dhësit. Ata e kishin parë edhe vjet edhe parvjet. E shihnin çdo vit. Por një dhës të këtillë, të ndërtuar me aq kujdes, ata s'kishin parë. Madje, atje ku ujët merrte kthesën për të hyrë në vijën e madhe që çonte tek arat e mbjella me misër, kooperativistët kishin shtruar plasmasët e duhanit.

Ata e nisën peshkimin shumë më lart vendit ku ishin shtruar plasmasët. Nuk i flisnin shoshoqit. Përkuleshin përmbi gurët e zbardhur nga uji, zgjatnin nëpër zgavrat e tyre duart e holla dhe mundoheshin të gjenin



ndonjë fole peshqish. Herë-herë ndonjëri zhytej i tëri ndënë gufën e ndonjë shpelle, ndërsa shoku i qëndronte pranë.

Kaloi shumë kështu. Të dy djemtë vazhdonin të kontrollonin strehët e gurëve, zgavrë, rrënjët. Ishte një gjuajtje e veçantë e peshkut kjo këtyre anëve. Ata e kapnin me dorë peshkun.

— Më mirë të kishim ardhur të dielën!  
— tha papritur Çaçi.

— Pse?

— Të dielën vinë të gjithë.

Ata flisnin pa e shikuar njëri tjetrin në sy. Flisnin duke shikuar brenda në ujë, tek vrima që gjuanin peshkun.

— Sot do të plehrohen dy dynymë më pak misër.

Shoku s'foli. Shokët e tyre në atë kohë po bënin pushimin e drekës, atje nën hijen e lisit të madh. Kushedi sa e kishin realizuar normën ata! Kushedi!!

Po për Çaçin dhe Hodon ç'thoshin vallah?... Të dy djemtë kishin rënë në mendime. Ata nisën të zëmëroheshin me veten e tyre. Mbrëmë në çair, të gjithë kishin zënë në gojë normat, të gjithë kishin folur për punët e fushatës, ndërsa ata të dy, kishin bluar të tjera mendime. Kur qenë larguar shokët, këta qenë hequr mënjanë dhe...

«Kushedi ç'ka thënë kryetari. Po, kushedi?! Ai gjithmonë shkonte nga skuadra e pionierëve. Po ndoshta ai s'thotë asgjë. Se as për Bertin atë ditë s'kishte thënë gjë. Po Berti kish shkuar të hiqte dhëmballën, ndërsa ne? Ne... Në fshat tashti s'gjen njeri. Të gjithë i janë përveshur punës. Edhe plakat. Vetëm ato gjyshet... Ne? Po... Ne s'jemi të vegjël. Kooperativa... Më mirë të kishim ardhur të dielë. Të dielë vinë të gjithë. Të dielë buçet lumi... Si?! Po Nasta tha që të dielë të ujitim misër me kova... Misër me kova!... Me kova!... Edhe Dashi... Po Dashi nuk e do lumin, nuk i do peshqit?... Sikur të kishim ardhur të dielë... Sikur të shpëtonin ato dardhët... Kooperativa...»

Papritur Hodua thirri:

— O, ç'më iku një ngjalë.

— Mirë, hidhe në anë — tha shoku pa ngritur kryet.

Të nxehtit ishte shtuar edhe më. Papritur, nga larg bëri zë një bubullimë e mbytur. Natyra zuri të errësohej dhe përreth u ngrit një erë, që pas pak mori krahë e vërshelleu grykës së lumit. Nëpër ajër ende një pluhur i verdhë, që e ngrinte era.

Djelmoshat shikuan njëri-tjetrin të habitur, pastaj shikuan nga dielli. Disku i zjarr-

të i diellit ngjante si një copë e shqyer. Kudo kish shpërthyer stuhia. Një stuhi e çmendur. Tej nga juga vraponin tufa të mëdha resh. Djemtë e kuptuan se nga çasti në çast po avitej furtuna. S'kaloi shumë dhe qielli i përmbytur nga retë dhe erërat u çap prej vetëtimave të zjarra.

Ata dolën dhe nisën të shpejtonin, por ndalën të lahtaritur nga shpërthimi i një bullime të tmerrshme që tundi tërë tokën. Në çast qielli u çap dhe nga lart u shkëput me rrebesh një shi i madh.

Të dy shpejtonin për tek vendi ku kishin fshehur rrobat. U çapitën ashtu një copë rrugë, lakuriq. Nga lart i rrihte rrebeshi, përreth era. Një tru u rrihte një mendim. Ai mendim i cëmbonte, i cëmbonte. Mbase ish zëri i shokëve tërë... Mbase...

Shiu herë platitej e herë ja jepte me hov edhe më të madh. Ata po u afroreshin teshave. S'kishin arritur ende, kur njëri thirri fort:

— Plasmasat, plasmasat!

— A? — thirri tjetri me zë edhe më të lartë.

— Plasmasët do t'i rrëmbejë lumi. Plasmasat janë të gjitha në dhes.

— Shpejt të kthehemi!

Djemtë u kthyen dhe menjëherë shpejtuan që të shpëtonin plasmasat. Se ata ishin fshatarë dhe e dinin sa të nevojshme ishin për fshatin ato lëndë plastike, të cilat i kishin sjellë që nga jashtë. Me to ngrohej e hidhte shtat domatja e herëshme, me to mbrohej e rritej në ditët e ftohta rasati i duhanit, me to...

Brungala e lumit u rrit. Uji, nga çasti në çast, po bëhej më i turbullt. Ata e ndalën vrapin buzë dhesit nga ana e përtejme e lumit. Duhej të nxirreshin plasmasat. Plasmasat... Sa e nevojshme ishte për fshatin plasma! Me to ngrohej e hidhte shtat... Plasmasat, ato lëndë plastike, të cilat...

Hodua u zhyt i pari. Pas tij Çaçi. Pastaj dolën përmbi ujë, duke shfryrë hundët.

— Ku do t'i hedhim? — e pyeti Çaçi shokun.

— Nga kjo anë, e kemi më lehtë, — pastaj shtoi: — të heqim gurët. Po shpejt. Dhe u zhyt. Edhe Çaçi. Qëndronin disa sekonda nën ujët e turbullt.

Shi binte aq shumë, sa brenda pak kohe shtretet e fjetur të katarakteve zunë të hedhin ujvara. Nëpër kodra, nëpër arat e korrura, suleshin tatëpjetë rrëke të turbullta. Bubullimat ndiheshin të tmerrshme, vetëti-

mat kryqëzoheshin, ndizeshin të zjarrta. Ndër-  
sa poshtë, tek dhesi, dy djelmosha hynin e  
dilnin duke u zhytur vazhdimisht.

Lumi sikur filloi të zhurmojë. Ujë të tur-  
bullt vinte i ngarkuar me ashkla, me degë,  
me duaj kulmakësh.

Ata i kishin nxjerrë katër copa të gjata  
plasmase. Dhe përsëri u zhytën. Tashti vono-  
heshin më shumë nën ujë. Delnin, merrnin  
frymë dhe përsëri zhyteshin, që t'i shpëtonin  
plasmasat.

E dini ç'do të thotë të rrëmbejë rrjedha  
një plasmasë, ato lëndë plastike të fshatit?

I pari doli Hodua nga uji. Mori frymë  
thellë. Pastaj priti sa doli dhe Çaçi.

— E gjeta! — thirri.

— Unë nuk e kam gjetur — tha Çaçi.

— E gjeta unë, këtu është. Ti mos u zhyt!

Dhe vetë ra brenda. Humbi ndënë atë  
zhurmë të errët, të lagur.

Pas ca çastesh doli, duke tërhequr me  
vete një rën anë të plasmasës. Të dy shokët u  
bënë bashkë. Dhe filluan të tërheqin me vë-  
shtirësi. Merrnin frymë me zor, duke shfry-  
rë. Herë-herë shikonin të alarmuar nga ujët,  
që sillte rrungaja.

Shtrati i lumit ishte mbujtur shumë.  
Gryka gjemonte. Dalëngadalë gjemimi erdh

e u rrit. Ujët e turbulluar kish mbritur deri buzë krodhit të dhesit. Edhe pak dhe...

— Tërhiqe, të zhytem edhe një herë —  
i tha Hodua shokut.

— Shpejt!

Sa nxori kryet Hodua, dhësi u ça, duke shpërthyer me bujë të madhe. Djelmohave u shpëtoi plasmasa. Ata e humbën ekuilibrin. Ujët e turbullt i vuri përpara. Por në një çast e morën veten. U kapën pas një rrapi të rrëzuar dhe, duke ecur pas trungut të tij që kish zënë vend, dolën në anë. Por dolën në anën tjetër të lumit. Jo nga ana e fshatit.

Ata ndenjën një çast aty, pastaj kapën ato katër copë plasmase dhe u munduan t'i nxirrnin më tej. Lumi sa vinte po e shtonte shtratin...

Ndërkohë, tatëpjetë kodrës, dy djemtë dalluan ca njerëz, që vareshin poshtë me të shpejtë. Ja, njeri ishte kryetari, tjetri babai i Laçifit.

Ata erdhën dhe ndenjën buzë dhesit nga ana e fshatit. Dhe mundoheshin të dallonin diçka nëpër sipërfaqen e ujit të turbullt. Djelmohat dëgjuan tek flisnin me zëra të lartë. Diç biseduan midis tyre dhe të dy, futën gish-tat tregues në gojë e vërshëllyen disa herë. Turma e burrave u step, kur pa ata dy djem

të zhveshur në anën e tejme të lumit. Folën, por djemtë s'dëgjuan gjë. Hodua dhe Çaçi kapën nga një anë të plasmasëve dhe i çuan lart. Kooperativistët e kuptuan se plasmaset kishin shpëtuar.

Burrat u avitën edhe më buzë lumit dhe, duke bërë me dorë andej, diç folën përsëri.

Shiu filloi të qetësohej, ndërsa lumi sa vinte e mbushte më shumë shtratin dhe shton-te edhe më uturimën.

Nga ai grup burrash u shkëputën dy ndër më të lartit e të bëshmit. Hynë në ujë dhe pa hedhur çapat e para, u kapën doradorës. Pastaj bënë të kapërxenin atë dallgë që vinte e përplasej tek trangu i rrapit të rrëzuar, kurmi i të cilit dalngadalë po humbiste nën turbullirë.

Por nuk bënë shumë çapa dhe u ndalën. U kthyen me fytyrë nga shokët. Dikush u thirrri fëmijëve me zë të lartë. Ata ju përgjegjën poashtu. Burrat e fshatit i mësuan dy djemtë që të shkonin më lart për të kapërcyer në pacarelën që gjendej nja gjysëm ore në drejtim të rrjedhës së lumit.

Ashtu u bë. Të dy djemtë shpejtonin matanë për në pacarelë, ndërsa nga kjo anë shpejtonte grumbullimi i burrave.

Kur ata u takuan, stuhia kishte rreshtur. —

## NDALE «SKODËN», BABA!

Babanë unë e kam shofer. Ai ka një «skodë» shytë dhe me të shëtiti pothuaj gjithë Shqipërinë. Por më shumë ai bën rrugën Tiranë-Korçë. Ngarkon mallra në Tiranë dhe i çon në Korçë, ngarkon mallra në Korçë dhe i sjell në Tiranë.

Ai ikën dhe ikën ditë e natë. Duket sikur s'fle, duket sikur s'ka shtëpi. Por ai na do fort neve, dhe ne e duam fort atë. Vetëm se është një çikë nevrik dhe po t'ja ngasësh, fjalla vjen, pasqyrën e maqinës me dorë, ai thërrret:

— Berti! Ç'të bëri pasqyra që e nget me dorë? Po deshe shikohu, po mos e nga me duar, se më bëhet pis.

Po të ulesh tek timoni, ai përsëri bërtet:

— Artan, Lere timonin, se duke e lëvizur kur maqina rri në vend, ka mundësi të kë-



putet! Hajde, bir i babit, zbrit poshtë se edhe këpucët i ke pis dhe do të më ndysh sediljet ku do të ulen pasagjerët!

Është ca i rreptë, sepse ka merak po t'ja ngasësh maqinën. Po zemrën e ka të bardhë. Ai na merr nganjëherë me maqinën e tij dhe na çon larg, larg nëpër rrugët e shumta të Shqipërisë, që herë shkojnë përmes fushave, herë gjarpërojnë sipër maleve të larta, herë hyjnë nëpër një grykë të thellë mali, herë shkojnë gjatë bregut të detit.

Ja, para ca kohe — udhëtova një javë rrjesht me babanë. Po të nisesh nga Tirana, ndalesën e parë e bën në Ibë, tek një kafe që shoferët i thonë «Kafja e Xhafës». Aty derdhet ujët e kulluar e të ftohtë të një çezme që buron nga mali dhe që s'e pushon këngën e gurgullimit as ditë, as natë, as në dimër, as në verë. Në qoftë se udhëtarët kanë etje, venë e pinë ujë në çezmë. Në qoftë se ndjejnë uri, venë e hanë ndonjë send në bufe. Në qoftë se ndjejnë në stomak trazimin që u shkakton udhëtimi, porositin ndonjë kafe me pak sheqer, ose të mesme dhe ulen e pinë aty jashtë derës në stolat dhe tavolinat e bojatisura, nën hijen e pjergullës.

Babai merr kovën, e mbush dhe fillon të

freskojë motorrin, të lajë spondet e karrocërisë apo gomat.

Pastaj vijon udhëtimi. Rruga tani është e përpjetë e me kthesa të shumta. Fillon ngjitja e Qafëkërrabës. Në anën e majtë, atje përtej, zbardhin ndërtesa e punëtorëve të minierës së qymyrgurit të Kërrabës. Pak më vonë ngjitesh në krye fare, në një lartësi të madhe dhe maqina, duke ecur nëpër kurrizin e malit, e shton shpejtësinë, kurse udhëtari rri e vështron; vështron malet e larta e krenarë të pështjellë me fasha reshë, vështron luginat e thella, greminat, prej nga po të biesh, bëhesh copë-copë, fushat e hijshme të tretura në mjegull andej tutje. Ndërsa në të djathtë, andej nga perëndimi, duket Adriatiku i kaltër që shkëlqen nën rrezet e diellit.

Ç'bukuri përrallore!

Sa i bukur është Atdheu!

Por ata që s'e kanë soditur nga malet, s'e dinë se ekziston një bukuri e tillë, e rrallë. Prandaj zemra e udhëtarit në ato çaste kërkon të shpërthejë e të flasë me ngazëllim:

— O njerëz! Hipuni maqinave dhe ngjitu në këtë lartësi të sodisim së bashku Atdheun! Shikoni si shkëlqen Adriatiku, si dia-

mant i kaltër, ndigjoni si oshëtijnë grykat e malet kreshnike, si trimat legjendarë, ndigjoni si fëshfërijnë fustanet gjelbëroshë të pyjeve, si fryn era e këndshme e mbushur me aroma lulesh mali!

Lulet e malit! . . .

Lulet e freskëta, që rriten në mes të pyllit, apo më ndonjë rudinë!

Lulet që rriten në shpate të maleve tona!

Ato nuk i mbjell dora e njeriut, por mbijnë vetë. Ato nuk i vadit njeriu, por vaditen vetë. Dora e ashpër e natyrës së maleve egër-sisht të bukura i përkëdhel ato lule. Barinjtë e vegjël, që kullosin delet e dhitë, venë i këpusin me kujdes kur lulëzojnë dhe formojnë buqeta me to. Pastaj ata dalin ndanë xhadesë dhe, kur shohin që vijnë maqinat, u zgjasin buqetat me lule. Mjaft shofera, ata që janë sevdallij dhe ua dinë vlerën luleve të malit, frenojnë në vend. Blejnë buqetën me lule dhe ja vënë maqinës në ballë.

Sa të bukura duken maqinat me kaçu-relat e vjollcave dhe trëndelinave në ballë! Si nuse të stolisura.

Udhëtimi vazhdon më tej. Pasi zbret Qafëkërrabën, arrin në Elbasan. Nga Elbasani

shkon në Librazhd, në Prenjas, kalon Qafën e Thanës, arrin në Pogradec, pastaj ndalon në Korçë.

Por tregimin tim do ta ndal në Qafëkërrabë, në atë lartësi ku duket deti Adriatik, Tomorri, Dajti, Polisi, Shkumbini, luginat. Sepse në atë mal, në një fshat poshtë xhadesë, jeton një djalë katërmbëdhjet vjeçar, që quhet Petrit.

Thashë në fillim se para ca kohe unë udhëtova një javë rrjesht nëpër atë rrugën me «Skodën», që drejton babi. Pas një jave babai nuk më mori më. Ditën e fundit të udhëtimit tim, kur po ktheheshim nga Korça, atë e pllakosi një fatkeqësi.

Kishim ngarkuar maqinën me mallra nga fabrika e trikotazhit në Korçë. Udhëtimi na kish shkuar mirë deri në Elbasan. Babai herë mbas here e ndalonte maqinën dhe delte jashtë; sillej rreth e rrotull «skodës» dhe kontrollonte në se mallrat në karroceri ishin në gjendje të mirë. Se, doemos, rruga është e gjatë, me të përpjetë e tatëpjeta dhe maqina pëson tronditje. Mirëpo babai im është i vjetër në zanat dhe mallrat i siguron mirë para se të niset për udhëtim.

Në Elbasan pushuam ndonjë gjysmë ore,

sa pimë nganjë aranzhatë. Babai e kontrolloi edhe një herë maqinën; gjithashka ishte në rregull. Pastaj u nisëm. Në kabinë kishim edhe dy udhëtarë që vinin për Tiranë. Ishin tifoza sporti. Edhe babai im është tifoz i «17 Nëntorit». Pa po të tre gjithë rrugës nuk bënin, veçse biseda për futbollin. Unë më të shumtën e kohës heshtja dhe admiroja natyrën dhe udhëtarët. Më pëlqen të hesht dhe të rri pranë dritares kur udhëtoj.

Filluam t'i ngjitemi Qafëkërrabës. Kjo qafë është shumë e përpjetë dhe me shumë kthesa, prandaj maqinat ecin ngadalë; herë me marsh të dytë dhe herë me të parin. Ka vende, pastaj, ku mund të ecish më shpejt në këmbë se sa me maqinë. «Skoda» rënkonte në atë të përpjetë.

Pastaj dolëm në krye dhe babai e ndroi marshin. «Skoda» filloi të ecte me shpejtësi. Dielli po varej nga perëndimi duke e bërë qiellin flakë të kuq. Disa dhi po kullosnin ndanë xhadesë. Bariu i tyre, një çunak, doli përpara dhe, duke tundur buqetën e luleve në duar, na bënte shenjë që të ndalonim.

— Ndale «skodën», baba! — i fola kur kaluam pranë çunakut, sepse ata të tre kishin humbur në diskutime të gjata.

— Ç'ta ndalojmë tani, — ma priti babai, — s'e shikon që dielli u var fare? S'kemi ndërmend të flemë këtu sonte, Berti.

— Mbaje «skodën», shofer! klithi djalo-shi kur e lamë pas.

Më erdhi keq për të. Unë doja që t'ja blenim tufën me lule dhe të zbukuronim me të si gjithnjë ballin e «skodës». Fëmijët e lagjes, posa ta shihnin si nuse të stolisur, do të vraponin drejt «skodës» sonë kur të mbrinin në Tiranë.

Prandaj i thirra përsëri babait:

— Mbaje të marrim një tufë lulësh mali, baba!

— Hesht të thashë një herë, Berti, se tani s'është vakti për lule! Po na presin në shtëpi.

Heshta i bindur. «Skoda» filloi të ecte me shpejtësi, sa dukej sikur fluturonte në atë lartësi.

Kur mbritëm në Tiranë, qielli qe errësuar. Tek kthesa në rrugën e Elbasanit babai e ndaloi maqinën, sepse zbritën udhëtarët, kurse ne shkuam edhe e lamë maqinën në magazinë.

Tirana kish shumë zhurmë, drita elektri-

ke, dhe nata ende s'qe ftohur. Në shtëpi na pritën krahëhapur.

Të nesërmen, kur babai i dorëzoi mallin magazinjerit, u vërtetua se një top prej njëqind kanatjeresh delte mangut.

— S'është e mundur! — kish ngulur këmbë babai dhe i kishin numëruar edhe një herë. Delnin mangut përsëri po aq kanatjere.

Kishin formuar një komision prej tre vetash. Por rezultati qe i njëjtë. I vunë gishtin rojes së magazinës, por ai bënte be e rrufe se gjatë kohës që shërbente ai, askush nuk kish hyrë e nuk kish dalë. Babai u bë gati si i çmendur. Njëzet vjet shofer kishte dhe ja, tani po i vihej një njollë që e shëmtonte shumë sedrën e tij të pastër.

Në shtëpi babai erdhi shumë i mërzitur. As i hahej as i pihej. Ndërmarrja tregëtare kish bërë procesverbal për mallin që delte mangut. Procesverbali ju përcoll parkut automobilistik. Drejtoria e parkut ja hoqi «skodën» babait.

O ç'fatkeqësi! Njëzet vjet me radhë që ushtronte profesionin e shoferit dhe ja, tani, po ndahej nga timoni.

— Nuk kam vetëm këtë hall, por çesh-

tja është se procesverbali mund t'i përcillet prokurorisë dhe mua do të më akuzojnë si vjedhës, — ankohej me dëshpërim babai. — Kjo është e tmershme, e padurueshme! Ja, ju katandisa edhe juve në ditë të hallit! Pastaj të mendosh se nuk do të kem më të drejtë të ngas maqinën. Hapu tokë dhe përpimë! . .

U dëshpëruam shumë edhe ne. Nëna filloi të qante, kurse Mimoza me Artanin nuk u silleshin më, si gjithnjë, nëpër këmbë. Ata rrinin jashtë dhe tek shihnin vërsnikët, që loznin në oborr, i ndernin veshët nga dhoma ku rrinte babai. Na deshte shumë dhe e deshnim, prandaj na pikonte në zemër për atë fatkeqësi. Këtëj e tutje ne nuk do të hipnim më në maqinë, sepse babait ja kishin marrë «skodën».

— A i hape sytë mirë, mor burrë, se mos t'i dhanë mangut në Korçë kanatjeret? Duhej t'i kishe hapur mirë, se ndonjë magazinjer mund dhe të ta hedhë, — i thoshte nëna.

— Ç'më thua tani, moj grua, malli u ngarkua në praninë time dhe unë i numërova vetë.

— E, po, s'ka mundësi t'i kesh marrë tamam.



— Po... edhe mund të rastisë një gjë e tillë.

— Të nisesh pa humbur kohë dhe të vesh edhe një herë atje ku ngarkove mallin. Lutju magazinierit dhe thuaji: «Mos më merr në qafë fëmijët!».

— Do të bëj një mundim një herë, por e di se më kot.

Dhe babai u nis për në Korçë.

Po atë ditë erdhi dhe e kërkoi dikush nga rajoni. Por babanë s'e gjeti. Në vend të tij shkova unë bashkë me mamanë.

— Burrit tuaj, moj shoqe e dashur, do t'i shkojë rruga bosh, — filloi tregimin shefi i rajonit, — sepse topi i kanatjereve u gjet.

Nënës i ndriti nuri, kurse mua m'u hodh përpjetë zemra prej gëzimit.

— U gjet?! — pyeti mamaja e emocionuar për t'u siguruar më mirë.

— Po. U gjet. Dhe për ta gjetur na ka ndihmuar një djalë katërmëdhjetë vjeçar, ja sa ky djali juaj, me emrin Petrit.

Ai banon në një nga fshatrat e Qafkrrabës, që ndodhet në një rudinë nën xhadenë e maqinave.

Mua më shkoi menjëherë mendja tek ai djali, që nxori dorën përpara duke tundur buqetën e luleve.

— Po, — vazhdoi shefi. — Ai është një djalë trim, i ndershëm dhe i zgjuar, ashtu siç janë malësorët tanë. Atë natë që burri juaj, Besniku, po kthehej nga Korça dhe po ngjitej me maqinë nëpër Qafëkërrabë, në një kthesë të fortë i ra një top me kanatjere!

— Isha edhe unë atë natë me babin! — i thashë shefit se nuk më durohej.

— Ashtuuu? Bukur fort. Ja edhe një dëshmitar tjetër.

Pasi dolët në majë fare dhe babai juaj ndrroi marshin, a ju doli një djalë përpara me një tufë lulësh në dorë dhe ju bëri shenjë të ndalonit?

— Po.

— E pra, ky është Petriti për të cilin po flas. Po pse s'e ndaloi maqinën babai juaj?

— Unë i thashë ta ndalonte, por ai nuk deshte të blinte lule atë mbrëmje, se dielli po perëndonte.

Shefi buzëqeshi:

— Ja, këtu qëndron fatkeqësia. Petriti ju bëri shenjë ta ndalonit, bile edhe ju bërti-

ti sepse, posa dolët në Qafë dhe maqina mori kthesën me të shpejtë, ai pa tek ra një top me kanatjere në xhade.

— Tani e kam të qartë, — u qetësova unë.

— Vonë, çunak, tepër vonë. Duhej ta kuptoje qysh n'ato çaste.

Heshta i mërzhitur. M'u kujtua ajo biseda e gjatë dhe e zjarrtë që kish hapur babai me ata dy bashkudhëtarët e kabinës dhe mallkova me vete të gjithë tifozët që, kur i kap sëmundja e tyre, jo vetëm s'marrin vesh vetë, por s'lënë as të tjerët të marrin vesh se ç'bëhet rreth e rrotull

— Ky djalë, — vazhdoi tregimin shefi, — posa pa se maqina nuk ndaloi, mori numrin e targës dhe vrapoi tek dengu me kanatjere. «Si t'ja bëj, cilin të lajmëroj?» kishte pyetur veten Petriti. «Të ndaloj maqinën e parë që do të shkojë këtej për në Tiranë dhe t'ja jap shoferit për ta dorëzuar në polici?... Kjo s'është ide e keqe. Por ka mundësi që shoferi të mos qëllojë njeri i ndershëm dhe mund t'i mbajë për vete kanatjeret. E mira e të mirave që që unë të shkoja t'i dorëzoja vetë».

Dielli po perëndonte n'anën tjetër, kurse poshtë xhadesë që ndehur hija e natës.

«Të nisem vetë më këmbë?, — mendoj përsëri Petriti dhe pa dhitë që po kullosnin ende. — Sa për dhitë, ato e dinë vetë rrugën për në shtëpi!» dhe mori tatëpjetë xhadesë. N'atë kohë pas kurrizit të tij jehoi buria e një xhipsi të gjeologëve. Petriti ktheu kokën, zgjati dorën përpara, kurse shoferi i xhipsit frenoi në vend.

Me të zbritur në Elbasan Petriti u drejtua për në polici, ku dorëzoi topin me kanajtjere dhe la targën e maqinës! — përfundoi shefi i Rajonit.

Nënës i rrodhën lotët prej gëzimit.

— Pa shih, pa shih se ç'djalë i mrekullueshëm! — pëshpëriste ajo herë pas here, duke i fshirë sytë e njomur me cep të shamisë.

Kur u kthyem në shtëpi, nëna s'pushonte së lavdëruari Petritin. Kjo gjë ma ka shtuar tepër kureshtjen për t'u njohur me atë djalë të maleve tona.

Tani pres me padurim të kthehet babai nga Korça dhe të nisim përsëri udhëtimet nëpër Shqipëri, sa pa filluar viti i ri shkollor. Kur të ngjitemi në Qafëkërrabë dhe të shohim një çunak me sytë e mprehtë, me leshra të prera shkurt dhe me një tufë lulesh në dorë, do të thërras me sa kam fuqi:

— Ndale «skodën», baba!... Të marrim një buqetë lulesh mali për t'i stolisur ballin maqinës dhe t'i shtërngojmë dorën e të përqafojmë Petritin, atë malësor të vogël që u tregua aq i shkathët dhe vigjilent për mbrojtjen e pasurisë së popullit, se unë dua ta njoh e ta kem si shembull!

Do të thërras me forcë sa zëri im të fluturojë nga ajo lartësi e të puthë me dashuri majat e Tomorrit e të Polisit, që shkëlqejnë si argjënd nën ndriçimin e diellit shqipëtar.